

FLAMUR KABASHI



Profecitë

Përshkrim i mrekullive të profetit Muhamed ﷺ

FLAMUR KABASHI

Profecitë

Përshkrim i mrekullive të profetit Muhamed ﷺ

Mitrovicë, 2018

Titulli:

Profecitë

Përshkrim i mrekullive të profetit Muhamed

Autor:

Mr. Flamur Kabashi



Redaktor fetar:

Dr. Muhamed Broja

Redaktor gjuhësor:

Jeton Koqinaj

Radhitja kompjuterike & kopertina:

Afrim Radoniqi

Botoi:

Viprint

Mitrovicë, dhjetor 2018, 1440 h

Parathënie

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili e zbriti Kuranin, e dërgoi Muhamedin ﷺ sqarues të tij, i dhuroi atij mrekulli të shumta për t'ia vërtetuar edhe më tej profetësinë, për t'ua shtuar besimtarëve bindjen dhe për t'ua qetësuar zemrat. Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Tij dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguari i Tij.

Historia e njeriut është vetë historia e profetëve, duke filluar nga njeriu i parë, Ademi ﷺ, që ishte profet, e deri te profeti i fundit, Muhamedi ﷺ. Allahu i Lartësuar nuk e la njerëzimin që të jetë në lajthitje e në huti në njohjen e Krijuesit, nuk e la në errësirrën e idhujtarisë dhe injorancës, në errësirrën e pasimit të egos e epsheve, por i udhëzoi ata, ua tregoi rrugën, u vendosi shenja në rrugë; gjithë kjo përmes librave dhe profetëve të Tij.

Në kohën tonë jetojnë rreth 8 miliardë njerëz. Kthehemi pak mbrapa: prej kohës së profetit Muhamed ﷺ e deri më sot, diku 1400 vjet, supozojmë se kanë jetuar me dhjetëra miliarda njerëz, pa pasur profet tjetër pos tij. Më tej, rreth 600 vjet para tij ishte profeti Isa ﷺ. Atëherë, vetëm nga kjo kohë e shkurtër (rreth 2000 vjet vetëm me dy profetë), kuptojmë se profetët janë të rrallë në histori, krahasuar me numrin e madh të njerëzve që kanë jetuar në një periudhë kaq të gjatë kohore.

Natyrisht, meqë këta profetë vinin me mesazh të madh hyjnor, duheshin përkrahur me mrekulli të ndryshme, që ishin thyerje të “ligjeve natyrore dhe atyre kozmologjike”, në mënyrë që të mos kishte asnjë lloj dyshimi rreth profetësisë së tyre dhe mesazhit që sillnin.

Dijetarët e hershëm muslimanë kanë shkruar libra rreth mrekullive të profetit Muhamed ﷺ, siç ishte Ebu Nuajm el Esbahani, imam Bejhekiu

etj., ku vëren se mrekullitë e tij profetike janë të shumta, duke filluar prej lindjes së tij, pamjes, sjelljes, fjalëve, veprave që i bënte, me një fjalë, tërë jetëpërshkrimi i tij ishte mrekulli më vete. Rrjedhimisht, kush e ka parë dhe e ka takuar, nuk ka dyshuar në këtë gjë.

Sa i përket këtij studimi, synojmë vetëm një kënd të jetës së profetit Muhamed ﷺ, që është përmbledhja e një pjese të haditheve (e jo të gjitha), fjalëve dhe veprave të tij, që ia vërtetojnë profetësinë.

Në shembujt që do të përmend nuk kam sjellë shenja të Kiametit, për të cilat ka lajmëruar Muhamedi ﷺ, ngase ato janë aq të shumta, saqë mund të përfshihen në libra të tërë, njëherazi për shumë shenja të Kiametit nuk mund të japim përgjigje precize se a kanë ndodhur apo jo, ose ku kanë ndodhur ato, andaj do t'u shmangem atyre.

Hadithet që janë përmendur në këtë studim, që të gjitha janë të pranuar ose të sakta dhe se gjykimi përkitazi me to është i mbështetur në mendimet e dijetarëve të hadithit a studiuesve të tij.

Kapitulli i parë

Kuptimi i dëshmisë “Muhamed Resulullah”

Dihet se shqiptimi i dëshmisë “La ilahe il-lallah, Muhamed Resulullah” është gjëja e parë që duhet të bëjë një person i cili dëshiron ta pranojë Islamin.

Kuptimi i dëshmisë “La ilahe il-lallah” në gjuhën shqipe është: Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut. Ndërkaq, kuptimi i “Muhamed Resulullah” është: Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

Ngaqë studimi ynë ka të bëjë me profecitë e Muhamedit ﷺ, atëherë do të bëjmë një shpjegim të shkurtër rreth dëshmisë “Muhamed Resulullah”. “Muhamed Resulullah” - Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ka dy shtylla kryesore:

1. Se ai nuk ka cilësi hyjnore, pra, është njeri i thjeshtë, jeton, ha, pi, martohet, sëmuret dhe vdes, sikurse njerëzit e tjerë;
2. Se atij i zbret shpallja prej Allahut, gjë e cila e dallon prej njerëzve. Argument për këtë është ajeti fisnik, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: Unë jam një njeri sikurse ju, mua më shpallet...”**¹

Ta pranosh Muhamedin ﷺ për profet dhe të besosh në të do të thotë:

- a. Të besosh se ai ka ekzistuar: Për këtë njeri të madh ka shkruar historia e njerëzimit, përfshirë historianët muslimanë e jomuslimanë, në gjuhën arabe dhe në gjuhë të tjera, ku deri më sot janë shkruar mijëra libra rreth tij, saqë nuk ka mundësi të numërohen. Tërë kjo është dëshmi e qartë se ai ka ekzistuar dhe se nuk është njeri i trilluar;

¹ El Kehf, 110.

- b. Të besosh në fjalët që ka thënë, që njihen si “hadithe ose thënie profetike”, të cilat janë vërtetuar se janë të sakta;
- c. Ta pasosh në atë me të cilën na ka urdhëruar, siç janë kryerja e obligimeve fetare;
- d. T’u shmangesh gjërave prej të cilave na ka ndaluar, që njihen si “haramë”, siç janë: alkooli, kamata, vjedhja, vrasja etj.;
- e. Ta adhurosh Allahun ashtu siç na ka mësuar ai, bie fjala, falja e namazit bëhet në përputhje me mësimet e tij, kryerja e haxhillëkut siç e ka bërë ai etj.;

Për të gjitha këto pika të lartpërmendura ka shumë argumente nga Kurani fisnik. Sa për ilustrim, po përmend disa: Allahu i Madhëruar thotë: **“Atë që jua jap i Dërguari, merreni, kurse atë prej së cilës ju ndalon, përmbajuni.”**²

Po ashtu thotë: **“Thuaj: Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit.”**³

Gjithashtu thotë: **“Në të Dërguarin e Allahut ju keni shëmbëlltyrë të mirë...”**⁴

Pastaj, nuk ka mundësi që ta besojmë Allahun përveçse përmes rrugës së profetëve dhe shpalljeve a librave qiellorë, e që për ne Allahu ka zgjedhur profetin Muhamed ﷺ.

Në anën tjetër, shumë dispozita fetare nuk i kemi në Kuran, porse Allahu i Madhëruar ato na i ka sqaruar përmes Profetit ﷺ, siç janë: forma, numri, lutjet e namazit, pastaj kushtet e tij etj. Të gjitha këto në Kuran jepen si urdhër i përgjithshëm (**Faleni namazin...**), kurse detajet e tjera janë vetëm në hadithe profetike.

- f. Ta duash atë dhe ta duash udhëzimin e tij:

² El Hashr, 7.

³ En Nur, 54.

⁴ El Ahzab, 21.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: Nëse e doni Allahun, më pasoni mua, që t’ju dojë Allahu.”**⁵

Muhamedi ﷺ thotë: *“Kush i ka tri gjëra, e ka shijuar ëmbëlsinë e besimit (imanit): që Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur tek ai se çdokush tjetër...”*⁶

- g. Të besosh se ai është dërguar për gjithë njerëzimin, tek arabët dhe joarabët, pa dallim ngjyre e race:

Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: O ju njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut te të gjithë ju...”**⁷

- h. Të besosh se ai është Profeti i fundit, vula e profetëve, e pas tij nuk do të ketë asnjë profet dhe se misioni i profetëve ka përfunduar me të, deri në Ditën e Kiametit.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Mirëpo është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve...”**⁸

Kështu, kujtdo që pretendon pas tij se është profet ose i shpallet diç, i themi se gënjen, ngase mesazhi profetik ka mbaruar me Muhamedin ﷺ.

Ka mundësi që këta gënjeshtarë të bëjnë disa gjëra të çuditshme, me të cilat i mashtrojnë njerëzit, ndonjë lëvizje të rrallë, lajmërim për ndonjë gjë të humbur etj., të cilat i bëjnë në bashkëpunim me djajtë (shejtanët). Mirëpo, dallimi mes tyre dhe Profetit shquhet fare lehtë. Profeti ka besim të pastër, thërret në besimin e Allahut, të Vetmit, nuk gënjen, nuk mashtron, nuk merret me pislleqe, nuk kërkon para për ideologjinë e tij, por çdo gjë që e bën, e bën me urdhrin e Allahut. Ndërkaq, këta të tjerët, që janë gënjeshtarë e magjistarë, falltarë e

5 Ali Imran, 31.

6 Buhariu (16) dhe Muslimi (43).

7 El Araf, 158.

8 El Ahzab, 40.

pretendues të profetësisë, nuk kanë besim të pastër e as vepra të mira (namaz, lëmoshë, edukatë). Thirrjen që e bëjnë, e bëjnë për dobi personale, për fitim parash ose diçka tjetër. Çdo gjë që e bëjnë, e bëjnë me urdhrin e djallit (shejtanit). Andaj, dallimi mes tyre dhe profetit Muhamed ﷺ është sikurse dallimi mes natës dhe ditës. Në fund, dije se pikat e lartpërmendura e përbëjnë mozaikun e besimit në profetësinë e Muhamedit ﷺ. Kushdo që lë ndonjë pikë, bie fjala, beson në fjalët e tij, porse nuk e pason atë, atëherë ka lënë një pjesë të mozaikut të besimit pa e plotësuar, rrjedhimisht ky besim është i mangët. Po ashtu, besimi në disa fjalë të tij dhe mohimi i disa të tjerave, me pretekst se nuk i përkap logjika, është gabim. Jo se jemi të thirrur ta lëmë logjikën, përkundrazi, Allahu na nxit të mendojmë, të meditojmë dhe të logjikojmë, porse logjika jonë duhet t'i lexojë mirë të dhënat e sakta historike dhe t'u besojë atyre që janë të vërteta. Jo çdo gjëje që shohim në natyrë duhet t'i besojmë, jo për çdo gjë që ekziston duhet të dimë gjithçka. Të gjithë besojmë në ekzistimin e shpirtit, porse shumë gjëra rreth tij nuk i dimë. I verbri nuk duhet të mohojë se ekzistojnë gjëra të bukura me pretekstin se nuk i sheh ato. Ne nuk duhet të polemizojmë për këtë çështje, ngase ka gjëra të fshehura që kanë ndodhur ose që do të ndodhin, porse ne nuk i perceptojmë dot. Por, kemi të drejtë të pyesim për vërtetësinë dhe burimin e tyre, ngase jo çdo gjë që thuhet a shkruhet, është e saktë. Mirëpo, pasi ta vërtetojmë lajmin ose ta kenë vërtetuar ekspertët e lëmit përkatës se është i saktë, ne i besojmë atij. Kjo është mesatarja që duhet ta ndjekim. Të mos e besojmë çdo lajm që thuhet, pa e vërtetuar saktësinë e tij, e as të mos e mohojmë çdo lajm që ndeshet me mendjen tonë, edhe nëse është i saktë. Nëse për një çështje të caktuar kanë shkruar librat e saktë, e kanë parë njerëzit

e besueshëm që kanë qenë aty, e ndoshta edhe kanë mbetur gjurmët e tij dhe prapë mohohet, kjo thjesht është mohim i së vërtetës. Kështu, ai i cili i beson Allahut, duhet t'i besojë edhe Fjalës së Tij, Profetit dhe Librit të Tij. Nëse ndodh e kundërta, që të pretendojë besimin në Allahun, mirëpo nuk beson në shumë gjëra që Ai i ka thënë, atëherë ky person e ka kundërshtuar vetveten. Nukka mundësi të besojë në Të, e të mos u besojë fjalëve dhe të dërguarve të Tij. Muslimani duhet të ketë parasysh se, besimi në mësimet e Kuranit fisnik dhe Hadithit profetik mund të vijë me gjëra të çuditshme, siç është besimi në botën tjetër, ose me gjëra të rralla, siç janë *mrekullitë e profetëve*, porse në asnjë mënyrë nuk mund të vijë me gjëra të pamundshme e të pakuptimta. Kjo, se Kurani është prej të Gjithëdijshtit, i Cili nuk harron, prej të Urtit, i Cili nuk gabon. Profetin e dërgoi i Plotfuqishmi, i Cili ka mundësi për çdo gjë, i Mëshirshmi, i Cili e bëri atë sqarues të rrugës së vërtetë. Krijuesi e shpiku botën prej asgjëje! Vallë, e ka të vështirë t'u japë mrekulli të dashurve të Tij?! Thjesht, besimi i mirëfilltë në Allahun e Madhëruar na mundëson të besojmë edhe në elementet e tjera të domosdoshme të besimit islam.

Kapitulli i dytë

Paralajmërimet profetike

Në këtë kapitull do të sjellim thëniet profetike, përmes të cilave ka paralajmëruar se do të ndodhin gjëra të caktuara, që me të vërtetë kanë ndodhur ashtu si ka paralajmëruar. Ajo që dihet mirëfilli është se të ardhmen nuk e di askush përpos Allahut, të Gjithëdijsmit, porse këto paralajmërimet janë vetëm një pjesë e vogël, të cilën Allahu ia mësoi dhe ia tregoi të Dërguarit ﷺ se do të ndodhin ashtu.

Paralajmërimi për Uvejs Karniun me përshkrim shumë të saktë

1. Usejr ibn Xhabiri rrëfen: Kur Omer ibn Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të) i venin grupe ushtarësh prej Jemenit, i pyeste: A është në mesin tuaj Uvejs ibn Amiri?

Derisa shkoi tek Uvejsi dhe e pyeti:

- Ti je Uvejs ibn Amiri?

- Po, - iu përgjigj ai.

- Nga Muradi, pastaj nga Karenit? - e pyeti (Omeri).

- Po, - iu përgjigj ai.

- Ke qenë i sëmurë nga lebra (gërbula) e më pas je shëruar, përpos një pjese sa dërhemi? - e pyeti.

- Po, - iu përgjigj ai.

- Ke nënë? - e pyeti.

- Po, - iu përgjigj ai.

Atëherë Omeri tha: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ të ketë thënë: “Do t’ju vijë Uvejs ibn Amiri me grup ushtarësh nga Jemeni, prej Muradit, pastaj prej Karenit. Ka qenë i sëmurë prej lebrës, por pastaj

është shëruar, përpos një pjese sa dërhem. Ai e ka nënën, të cilën e respekton shumë. Sikur të betohet në Allahun për diç (që të bëhet), Ai ia plotëson atë. Nëse të jepet mundësia, kërkoji që të lutet (tek Allahu) për ty për falje.”

- Kërko falje për mua, - i tha Omeri.

Së këndejmi, Uvejsi kërkoji falje për të (tek Allahu)...⁹

Uvejs ibn Amir Karniu ishte prej gjeneratës që nuk e kanë takuar Profetin ﷺ, madje ishte nga Jemeni, një distancë mbi një mijë kilometrash largësi. Megjithatë, përshkrimin që ia bëri Profeti ﷺ ishte shumë i saktë. Gjithashtu, gjë e çuditshme ishte bindja e Omerit se do ta takojë atë dhe vërtet e takoi, diku dy vjet e më tepër pas vdekjes së Profetit ﷺ.

Paralajmërimi për vrasjen e Amar ibn Jasirit

2. Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të) rrëfen: (Gjatë ndërtimit të xhamisë) ne bartnim nga një tullë, ndërsa Amar ibn Jasiri bartte nga dy tulla. E, kur i Dërguari ﷺ e pa atë, ia shkundi dheun dhe i tha: “Mjerë për Amarin! Do ta vrasë grupi i rebeluar: ai i thërret në Xhenet, ndërsa ata e thërrasin në Zjarr.”

Atëherë Amari tha: I kërkoj Allahut të më mbrojë nga sprovat (fitnet)¹⁰.

Amari u vra pas moshës nëntëdhjetëvjeçare, në Luftën e Sifinit, e cila u zhvillua në vitin 37 sipas hixhretit. Ai ishte nën komandën e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të ta), kalifit të katërt, dhe i thërriste

⁹ Muslimi (2542).

¹⁰ Buhariu (447) dhe Muslimi, me tekst të përafërt (2915).

kundërshtarët, që edhe ata t'i nënshtrohen atij¹¹.

Paralajmërimi për kohëzgjatjen e kalifatit të drejtë

3. *Seid ibn Xhumhani, përcjellë nga Sefine (Allahu qoftë i kënaqur me ta) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kalifati profetik do të jetë tridhjetë vjet, pastaj Allahu ia jap mbretërinë, ose mbretërinë e Tij, kujt të dojë.” Seidi tha: Më ka thënë Sefine: Numëro: dy vjetët e Ebu Bekrit, dhjetë të Omerit, dymbëdhjetë të Othmanit dhe kaq të Aliut...¹²*

Dhe, vërtet ashtu ndodhi. Profeti ﷺ vdiq në muajin e tretë, të vitit 11 sipas hixhretit, kurse Aliu, i cili ishte kalifi (prijësi) i fundit, vdiq në muajin e nëntë, të vitit 40 sipas hixhretit¹³.

Paralajmërimi se Fatimja do të jetë personi i parë nga familja që do të vdesë pas tij

4. *Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) tregon: I Dërguari i Allahut ﷺ e thirri vajzën e tij, Fatimen, i foli (në vesh), e në atë rast ajo qau, pastaj prapë i foli (në vesh), porse ajo qeshi.*

Aishja i tha Fatimes: Çfarë të tha (në vesh) i Dërguari i Allahut ﷺ, që qave, pastaj të foli, e ti qeshe?

- Më foli e më tregoi për vdekjen e tij, andaj qava. Pastaj më foli sërish e më tregoi se unë do të jem e para prej familjes së tij që do ta pasoj atë (me vdekje), andaj qesha, - u përgjigj ajo¹⁴.

11 El Istiab, vëllimi 3, f. 1138-1140; Fet-hul Bari, vëllimi 1, f. 542.

12 Ebu Davudi (4646).

13 El Istiab, vëllimi 1, f. 47 dhe vëllimi 3, f. 1122.

14 Muslimi (2450).

Dhe, kjo ndodhi, ngase ajo vdiq diku gjashtë muaj pas Profetit ﷺ dhe se ishte e para që vdiq prej familjes së tij¹⁵.

Paralajmërimi për gruan e parë të tij që do të vdesë pas tij

5. *Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ajo që më së shpejti do të më bashkëngjitet mua (me vdekje) është ajo që i ka duart më të gjata.”*

Ajo tregon: Ato (gratë e të Dërguarit ﷺ) i zgjasnin duart për të parë cila i kishte duart më të gjata. Zejnebja ishte më dorëgjata, ngase ajo punonte me duar të veta dhe jepte lëmoshë¹⁶.

Kuptimi i dorëgjatës është alegori për dhënien e lëmoshës dhe bujarisë¹⁷. Zejnebe bint Xhahshi ishte gruaja e parë e Profetit ﷺ, që vdiq pas tij, andaj e kuptuan se për çfarë gjatësie duarsh kishte fjalën ai. Ajo vdiq në vitin 20 sipas hixhretit¹⁸.

Sqarim: Hadithi i Fatimes ka për qëllim personin e parë që do të vdesë prej familjes së tij, ndërsa hadithi i këtij nëntitulli ka për qëllim vetëm gratë e Profetit ﷺ, ngase atyre iu është drejtuar me ato fjalë.

Paralajmërimi se Haseni do t'i pajtojë dy grupe muslimanësh

6. *Ebu Bekrete (Allahu qoftë i kënaqur me të) rrëfen: Teksa i Dërguari i Allahut ﷺ mbante hutben (ligjëratën), erdhi Haseni. Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Ky djali im është zotëri, mbase me të Allahu do t'i*

15 El Istiab, vëllimi 4, f. 1894 dhe f. 1898.

16 Muslimi (2452).

17 Sherh Muslim, Neveviu, vëllimi 16, f. 8.

18 El Istiab, vëllimi 4, f. 1850 e f. 1852 dhe Neveviu, Sherh Muslim, vëllimi 16, f. 8.

*pajtojë dy grupe muslimanësh.*¹⁹

Së këndejmi, ashtu ndodhi. Pas vrasjes së Aliut, udhëheqësinë e muslimanëve e mori i biri i tij, Haseni. Në këtë kohë ai ishte në konflikt me Muavi ibn Ebu Sufjanin, e që secili prej tyre kishte numër të madh pasuesish. Haseni, për hir të pajtimit dhe ndaljes së vrasjeve, udhëheqësinë ia lëshoi Muaviut, kështu që ky vit u quajt *Viti i Unitetit*, për shkak të bashkimit të njerëzve dhe përfundimit të luftës²⁰.

Paralajmërimi se muslimanët do të bëjnë haxhillëkun edhe prej Shamit

*7. Nga Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ ua caktoi (emërtoi vendet e mikateve për haxhillëk dhe umre) banorëve të Medinës Dhul Hulejfen, banorëve të Shamit El Xhuhfen, banorëve të Nexhdit Karnel Menazilin dhe banorëve të Jemenit Jelemlemin...*²¹

Dihet se në atë kohë Shami nuk kishte muslimanë, porse Profeti ﷺ paralajmëroi se muslimanët edhe prej aty do të bëjnë haxhillëkun, saqë ua caktoi edhe vendin se ku duhet të ndalen për ta bërë hyrjen në ihram, qoftë për haxhillëk, qoftë për umre.

Në kohën e kalifatit të Omerit, Shami ka hyrë nën qeverisjen e muslimanëve, kur ka filluar përhapja e Islamit në popull dhe kështu në periudhën kohore prej më pak se dhjetë vjetësh u realizua kjo mrekulli profetike.

¹⁹ Buhariu (7109).

²⁰ Ibn Batali, Sherh Sahih el Buhari, vëllimi 8, f. 96-97 dhe Fet-hul Bari, vëllimi 13, f. 63.

²¹ Buhariu (1524) dhe Muslimi (1181).

Paralajmërimi për dëgjimin e zërit të qenve në vendin e quajtur Heveb

8. Nga Kajs ibn Ebu Hazimi transmetohet të ketë thënë: Kur Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) u nis dhe arriti natën te Puset e Beni Amirit, aty lehën qentë. Ajo pyeti: Cili pus është ky?

- Pusi Heveb, - iu përgjigjën ata.

- Nuk mendoj tjetër, vetëm se të kthehem, - tha ajo.

- Assesi. Do të ecësh përpara, derisa të të shohin muslimanët, e Allahu i Madhëruar t'i pajtojë mes vete, - tha dikush që ishte me të.

Atëherë Aishja (duke treguar arsyen e kthimit të saj) tha: Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ na tha neve (grave të tij): “Si do të jetë puna e njëres prej jush, kur qentë e Hevebit do t'i lehin asaj?”²²

Sa interesante! Puset e vendit Heveb ndoshta nuk i has as në hartë! Ato janë në thellësi të Irakut, rrugës për në qytetin Basra²³. Por, Profeti ﷺ i paralajmëroi gratë e tij se njëra prej tyre do të kalojë andej. Gjë tjetër e mrekullueshme është paralajmërimi se edhe qentë do t'i lehin asaj. Për këtë arsye, Aishja në momentin që e kuptoi se ky është vendi Heveb, pothuajse u trishtua dhe menjëherë u kthye prapa. Kjo ka ndodhur diku njëzet e pesë vjet pas vdekjes së Muhamedit ﷺ.

Paralajmërimi se Allahu do ta vrasë Musejleme Kedhabin (gënjeshtarin)

9. Nga Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet

22 Ahmedi (24254), Ibn Hibani (6732) dhe Hakimi (4613). Hadithin e konsiderojnë të saktë: Ibn Hibani, Hakimi, Ibn Kethiri, Ibn Haxheri etj. (Tehdhib et-tehdhib, vëllimi 8, f. 389; El-Bidajeh ven-Nihajeh, vëllimi 6, f. 236; Fet-hul Bari, vëllimi 13, f. 55).

23 Shihabudin Jakut el Hameviu, Muxhem el-Buldan, vëllimi 2, f. 314.

të ketë thënë: Në kohën e të Dërguarit të Allahut ﷺ (në Medinë) erdhi Musejleme Kedhabi (gënjeshitari) me shumë njerëz të popullit të tij dhe tha: Nëse Muhamedi ma trashëgon mua këtë çështje (profetësinë) pasi të vdesë, do ta pasoj atë. I Dërguari i Allahut ﷺ shkoi tek ai së bashku me Thabit ibn Kajs ibn Shemasin, ndërsa në dorë mbante një degë palme. Kështu, u ndal te Musejleme, i cili ishte me shokë, dhe i tha: “Nëse ma kërkon edhe këtë copë (degë), nuk do të ta jap, ndërsa ti nuk do ta tejkalosh urdhrin e Allahut mbi ty, e, nëse kthehesh (pa më besuar mua), Allahu do të të vrasë. Unë po shoh në ty atë që tanimë e kam parë.”²⁴

Pikërisht, ashtu ndodhi. Musejleme gënjeshitari u vra në Betejën e Jemames në vitin 11 sipas hixhretit²⁵.

Profeti ﷺ i tregoi Enesit kush dhe me çfarë e kishte dërguar atë

10. Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: (Shkova dhe) e gjeta të Dërguarin e Allahut ﷺ në xhami, e me të ishin disa njerëz, ndërkaq ai më tha: “Të ka dërguar Ebu Talhai?”

- Po, - i thashë.

- Për ushqim? - pyeti ai.

- Po, - i thashë.

Atëherë, atyre që ishin me të, u tha: “Ngrihuni.”

Kështu, ai vajti dhe unë vajta në mes tyre²⁶.

Ebu Talhai e kishte dërguar Enesin që ta thërrasë Profetin ﷺ në gosti.

²⁴ Buhariu (3620) dhe Muslimi (2273).

²⁵ El-Bidajeh ven-Nihajeh, vëllimi 6, f. 325.

²⁶ Buhariu (422), teksti i të cilit është, kurse Muslimi (2040) më gjerësisht.

Enesi sapo e takoi Profetin ﷺ, ende pa i treguar, Profeti ﷺ ia priti se Talhai të ka dërguar të më thërrasësh për në gosti.

Paralajmërimi për shkresën e Hatibit dërguar mekasve

11. Nga Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ më dërgoi mua, Zubejrin e Mikdad ibn Esvedin dhe tha: “Nisuni derisa të arrini në Reudatu Hah (vend mes Mekës dhe Medinës), ku është një grua, e cila ka një shkresë, dhe merrjani.”

Ne u nisëm dhe kuajt na dërguan shpejt derisa arritëm në Reudatu. Kur ja, grua ja në fjalë. I thamë: Nxirre shkresën.

- Nuk kam shkresë, - tha ajo.

- Ose do ta nxjerrësh shkresën, ose do të t'i zhveshim rrobat (për të ta marrë letrën), - i thamë.

Atëherë ajo e nxori atë prej gërshetës së vet dhe ne ia dërguam të Dërguarit të Allahut ﷺ, kur ja, në të shkruante:

Prej Hatib ibn Ebu Beltahut te disa idhujtarë të Mekës, si dhe i informonte për diç prej çështjes (planit) të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ i tha: “Çështë kjo, o Hatib?”

- O i Dërguari i Allahut ﷺ, mos u ngut në raport me mua. Unë isha njeri i afërt me kurejshët, por nuk isha prej tyre, ndërsa muhaxhirët, që janë me ty, në Mekë kanë farefisni me të cilët kanë siguruar pasuritë dhe familjet. Meqë nuk kisha farefisni me ta, doja të kisha dorë mbi ta, që ta ruaja afërsinë time me ta. Këtë nuk e bëra duke mohuar, duke lënë fenë a duke qenë i kënaqur me kufër (mohim) pas Islamit, - u përgjigj ai.

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Të vërtetën jua tha...”²⁷

²⁷ Buhariu (3007) dhe Muslimi (2494).

Sa e bukur kjo! Profeti ﷺ u tregoi këtyre tre shokëve të tij për këtë letër sekrete, të cilën e kishte ajo grua dhe vendin ku do ta takojnë atë. Në anën tjetër, kemi bindjen e atyre burrave se vërtet ajo e posedonte atë shkresë, andaj nuk u luhatën në kërkesën e tyre, por patjetër i duhej asaj ta nxirrte atë.

Lajmërimi për vdekjen e Nexhashiut

12. Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ na lajmëroi për vdekjen e Nexhashiut, prijësit të Abisinisë, ditën kur ai vdiq dhe tha: “Kërkoni falje për vëllanë tuaj.”²⁸

Nexhashiu ishte mbret i Abisinisë, i cili ishte bërë musliman, ndërsa distanca mes tij dhe Profetit ﷺ, i cili ishte në Medinë, ishte me qindra kilometra largësi dhe se mes dy vendeve është edhe Deti i Kuq. Kështu, arritja e lajmit për vdekjen e tij mu në ditën e vdekjes, ishte mrekulli e kohës.

Paralajmërimi për sigurinë që do të mbretërojë në Gadishullin Arabik

13. Nga Habab ibn Ereti (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Shkova tek i Dërguari ﷺ teksa ai kishte vendosur (nën kokë) një rrobë me vija dhe ishte nën hijen e Qabesë, ndërsa ne ishim në gjendje të rëndë prej idhujtarëve, andaj i thashë: O i Dërguari i Allahut, a nuk po e lut Allahun (për të na ndihmuar). Atëherë ai u ul, fytyra iu skuq dhe tha: “Ata që ishin para jush, janë krehur me krehër të hekurt

²⁸ Buhariu (1327) dhe Muslimi (951).

deri tek ashti nën lëkurë ose në nyjë dhe kjo nuk i largonte nga feja e tyre. Po ashtu, ia vendosnin sharrën në mes të kokës dhe e ndanin në dysh, por kjo nuk e largonte nga feja e tij. Allahu do ta plotësojë këtë çështje (fe), saqë kalorësi do të lëvizë prej Sanasë deri te Hadrameuti²⁹, e nuk do të frikësohet nga askush, përveç nga Allahu.”³⁰

Ky hadith përshkruan gjendjen e rëndë të muslimanëve në periudhën mekase, saqë edhe iu ankuan Profetit ﷺ për këtë gjendje të rëndë. Mirëpo, Profeti ﷺ i përgëzoi ata dhe i lajmëroi se së shpejti besimtarët do të jenë të sigurt në këto vende.

Për këtë, dijetari Ibn Batali, gjatë shpjegimit të këtij hadithi, ka thënë: Në këtë hadith ka mrekulli profetike, ngase është vërtetuar ajo që ka thënë Profeti ﷺ se feja do të plotësohet, e kjo çështje do të përhapet dhe se Allahu do ta përmbushë atë që i ka premtuar Dërguarit të Tij.³¹

Paralajmërimi se nga fisi thekif do të dalë një gënjeshtar dhe një shkatërrues

14. Nga Esmā bint Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet t'i ketë thënë Haxhaxh ibn Jusufit (i cili ishte prijës mizor dhe tiran i madh): I Dërguari i Allahut ﷺ na ka treguar se: “Në fisin thekif do të jetë një gënjeshtar dhe një shkatërrues.”

(Esmā vazhdon:) Sa i përket gënjeshtarit, e kemi parë atë, ndërsa shkatërruesin, nuk mendoj në askënd pos teje.

29 Që të dyja gjenden në Jemen. Sanaja është në perëndim, kurse Hadrameuti në lindje, ndërsa distanca mes tyre është mbi 500 km.

30 Buhariu (3852).

31 Ibn Batali, Sherh Sahih el Buhari, vëllimi 8, f. 297.

*Atëherë ai u largua prej saj dhe nuk u mor me të.*³²

Të gjithë dijetarët janë të një mendimi se gënjeshtari ishte Muhtar ibn Ebu Ubejd Thekafiu, ndërsa shkatërruesi Haxhaxh ibn Jusuf Thekafiu.³³

Paralajmërimi për Omerin dhe Othmanin se do të bien dëshmorë (shëhidë)

15. Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: (Një ditë) Pejgamberi ﷺ, Ebu Bekri, Omeri dhe Othmani hipën mbi Uhud (kodër në Medinë), e (Uhudi) u dridh. Atëherë (i Dërguari i Allahut) tha: “Stabilizohu (mos u dridh), o Uhud, se mbi ty është një profet, një i singërtë (Sidiku) dhe dy dëshmorë (shëhidë).”³⁴

Omeri është vrarë në Xhaminë e Profetit ﷺ nga një persian, i cili quhej Ebu Lulu Mexhusi, në vitin 23 sipas hixhretit.³⁵ Ndërkaq, Othmani është vrarë në shtëpinë e tij në Medinë në vitin 35 sipas hixhretit.³⁶ Sa i përket Othmanit, kemi edhe një paralajmërim tjetër profetik në lidhje me të. Ebu Musa Eshariu, në një hadith të gjatë, transmeton se Othmani kërkoi leje të futej te Profeti ﷺ, i cili ishte së bashku me Ebu Bekrin dhe Omerin te një pus i quajtur Eris. Ebu Musai shkoi te Profeti ﷺ dhe i tregoi se Othmani ishte te dera. Atëherë Profeti ﷺ i tha: “Jepi leje dhe

32 Muslimi (2545).

33 Imam Neveviu, Sherh Muslim, vëllimi 16, f. 100.

34 Buhariu (3675).

35 Dhehebiu, Tarih el Islam, vëllimi 2, f. 138, 153 dhe Ibn Kethiri, El-Bidajeh ven-Nihjeh, vëllimi 7, f. 130.

36 Dhehebiu, Tarih el Islam, vëllimi 2, f. 232 dhe Ibn Kethiri, El-Bidajeh ven-Nihjeh, vëllimi 7, f. 170.

përgëzoje me Xhenet së bashkë me një sprovë që do ta godasë...”³⁷

Kështu u vërtetua paralajmërimi i Profetit ﷺ se që të dy do të vriten dhe do të jenë dëshmorë.

Paralajmërimi për përfundimin e titullit kisra dhe kajzer

16. Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Vdiq kisrai (titull mbreti persian) dhe më nuk do të ketë kisra. E, kur të vdesë kajzeri (Cezari, perandori romak), nuk do të ketë më kajzerë. Beto hem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, se thesaret e tyre do të shpenzohen në rrugën e Allahut.”³⁸

Historiani Ali Gamidi³⁹ thotë: Kuptimi i hadithit është shumë i qartë, ngase kisrai që jetonte në kohën e Profetit ﷺ dhe të cilit i kishte dërguar letrën e njohur, përmes së cilës e ftonte në Islam, quhej kisrai Parviz. Ky luftoi kundër romakëve, kurse mbretërit që erdhën pas tij, duke filluar prej djalit të tij Shahrijar e deri te mbreti i fundit i Persisë, Jezdexherdi i Tretë, të gjithë u njohën me emrat e tyre dhe asnjëri nga ata nuk u emërtua me titullin kisra. Kështu, kisrai Parviz ishte kisrai i fundit dhe nuk kishte më kisra të tjerë.

Po ashtu, për kajzerin thotë: Kajzeri që jetonte në kohën e Profetit ﷺ dhe të cilit i kishte dërguar letrën e njohur, përmes së cilës e ftonte në Islam, ishte Herakli. Vërtet ky ishte kajzeri i fundit, pas të cilit nuk kishte kajzerë të tjerë, ashtu siç e potencon hadithi. Kjo ndodhi për shkak se perandori Herakli, i cili njihej me titullin kajzer, në vitin 629, pasi triumfoi kundër Persisë, ia mësyu shfuqizimit të titujve të vjetër

³⁷ Buhariu (3674) dhe Muslimi (2403).

³⁸ Muslimi (2918).

³⁹ Profesor i historisë në Universitetin Umul Kura, në Mekë.

romakë, me të cilët emërtoheshin perandorët, siç ishin: Kajzeri dhe Augusti...

Në këtë vit Herakliu mori një titull tjetër, të cilin e mori nga greqishtja, pra titullin basileus. Me këtë titull e emërtoi edhe djalin e tij, Konstantinin, dhe djalin tjetër, Herkalunasin. Kështu, Herakli ishte kajzeri i fundit dhe se pas tij nuk kishte më kajzerë, ashtu siç lajmëroi “i vërteti dhe i vërtetuari” (Profeti ﷺ), i cili nuk flet sipas mendjes së tij, porse sipas shpalljes që i shpallet atij. Kjo është një mrekulli e bukur dhe një argument i qartë për profetësinë e tij ﷺ.⁴⁰

Paralajmërimi se njëri nga shokët e tij do të vdesë i vetmuar në shkretëtirë, por atë do ta varrosin një grup muslimanësh

17. Umu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të) rrëfen: Kur Ebu Dherrit iu afrua vdekja, unë qava, e ai tha: Pse po qan?

- Si të mos qaj, kur ti po vdes në shkretëtirë, ndërsa unë nuk kam as dorë (fuqi) të të varros, as rroba që të mjaftojnë për qefin, - tha ajo.

- Mos qaj, por përgëzohu, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Nuk ndodh që një çifti musliman t’u vdesin dy-tre fëmijë, të cilët bëjnë durim dhe shpresojnë (në shpërblimin e Allahut), e ta shohin Zjarrin ndonjëherë.”

Po ashtu e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Njëri prej jush do të vdesë në një tokë shkretëtire dhe do ta përcjellin një grup muslimanësh.”

(Ebu Dherri shtoi:) Të gjithë ata që ishin aty, kanë vdekur në vendbanime ose në prani të njerëzve, ndërsa unë jam ai që po vdes në shkretëtirë. Betohem në Allahun se unë nuk po të gënjej e as ai nuk më ka gënjyer.⁴¹

40 Dr. Ali el Gamidi, El-Harb bejne er-rum vel-furs, fi deu-i suret er-Rum, f. 51-52.

41 Ahmedî (21373), Ibn Hibani (6670) dhe Hakimi (5470). Ibn Hibani, Hakimi, Hejthemi

Paralajmërimin që ua kishte thënë Profeti ﷺ shokëve të tij e vërtetoi Ebu Dherri, sepse ashtu ndodhi. Ai vdiq në një shkretëtirë, i vetëm me gruan e tij, porse aty kaluan një grup besimtarësh prej Jemenit, të cilët e qefinosën, ia falën namazin e xhenazes dhe e varrosën atë.⁴²

Paralajmërimi për daljen e disa njerëzve që do ta mohojnë Hadithin

19. Nga Mikdam ibn Madi Keribi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ në ditën e Hajberit ndaloi disa gjëra, pastaj tha: “Do të vijë koha kur ndonjëri prej jush, duke qenë i mbështetur në kolltukun e tij, të më përgënjeshtrojë mua: Atij i citohet hadithi im, ndërsa ai thotë: Mes nesh dhe jush është vetëm Libri i Allahut. Atë që e gjejmë të lejuar në të, e lejojmë, e atë që e gjejmë të ndaluar, e ndalojmë. (Pastaj Profeti ﷺ vazhdoi:) Atë që e ka ndaluar i Dërguari i Allahut ﷺ është sikur ta ketë ndaluar Allahu.”⁴³

Dijetari i njohur, Mustafa Sibai, tregon zanafillën e shfaqjes së këtij grupi njerëzish, të cilët e mohojnë argumentimin me Sunet ose hadith profetik dhe se mjaftohen vetëm me Kuran. Ai thotë se ky grup është shfaqur në kohën e imam Shafiut, përkatësisht ishin disa pasues të mendimit mutezili në qytetin e Basrës⁴⁴.

(Mexhme ez-zevaid, vëllimi 9, f. 332) e konsiderojnë të saktë, kurse recensuesit e Musnedit të Ahmedit e konsiderojnë hasen - të mirë (vëllimi 35, f. 300).

42 Ibn Hibani (6670) dhe Hakimi (5470).

43 Ahmedit (17194), Tirmidhiu (2664), i cili thotë se është hasen garib. Hadithi ka edhe rrugë të tjera, të cilat e forcojnë atë, siç është transmetimi i Ebu Davudit (4604).

44 Es-Sunneh ve mekenetuha fit-teshri el-islamij, f. 165.

Ndërkaq, në kohën bashkëkohore përmend një person me emrin Teufik Sidki, i cili ka shkruar një temë me titullin “Islam është vetëm Kurani.”⁴⁵

Sigurisht, ky mendim është në kundërshtim të plotë me vetë Kuranin, siç është sqaruar në kapitullin e parë, porse këtu kemi për qëllim të përmendim vetëm vërtetësinë e asaj që ka paralajmëruar Profeti ﷺ se do të dalin njerëz që do ta mohojnë Hadithin e tij dhe se do të mjaftohen vetëm me Kuran.

Paralajmërimi për çlirimin e Egjiptit dhe për një ngatërresë që do të ndodhë në vendin Lebine

20. Nga Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ju do ta çlironi Egjiptin, një vend, ku (monedha) quhet kirat. Kur ta çlironi atë, silluni mirë me banorët e tij, ngase me ta kemi marrëveshje dhe afërsi, ose marrëveshje dhe miqësi. Kur t’i shohësh dy burra duke u grindur atje, mu në vendin Lebine, dil prej aty.”

(Ebu Dherri vazhdon): Kur pashë Abdurrahman ibn Shurejhbil ibn Hasanen dhe vëllanë e tij Rabia duke u grindur në vendin Lebine, atëherë dola prej aty⁴⁶.

Në këtë hadith kemi dy paralajmërime:

I pari: Çlirimin e Egjiptit, i cili hyri nën qeverisjen e muslimanëve gjatë kalifatit të Omer ibn Hatabit, në vitin 21 sipas hixhretit (642).

I dyti: Ebu Dherri do t’i shohë dy persona duke u grindur në vendin

⁴⁵ Es-Sunneh ve mekenetuha fit-teshri el-islamij, f. 176.

⁴⁶ Muslimi (2543).

Lebine dhe kjo ndodhi ashtu siç lajmëroi i vërteti, Muhamedi ﷺ. Për këtë arsye, Ebu Dherri u largua prej atij vendi, pasi ashtu e kishte porositur Profeti ﷺ.

Kapitulli i tretë

Lutjet profetike

Në këtë kapitull do të sjellim lutjet e Profetit ﷺ, qoftë për të mirën e dikujt, qoftë kundër dikujt, njëherazi do të shohim se Allahu i Madhëruar, i Cili është afër robit të Tij e që dëgjon dhe sheh, iu përgjigj atij, duke ia plotësuar lutjet brenda një kohe shumë të shkurtër.

Lutja që bëri për udhëzimin e nënës së Ebu Hurejrës

1. Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Teksa nëna ime ishte idhujtare, e ftoja në Islam, saqë një ditë, kur i fola, ajo shqiptoi për të Dërguarin e Allahut ﷺ diç që unë urreja. Kështu, vajta tek i Dërguari i Allahut ﷺ duke qarë, e i thashë: O i Dërguari i Allahut, unë e ftoja nënën në Islam, porse ajo më kundërshtonte, e edhe sot e ftoja, por për ty foli atë që unë e urrej, andaj lute Allahun që ta udhëzojë nënën e Ebu Hurejrës. Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ u lut: “O Allah, udhëzoje nënën e Ebu Hurejrës!” Sakaq, unë dola i gëzuar për lutjen e tij, e, kur shkova dhe ia mësyva derës, e cila ishte e mbyllur. Kur nëna ime i dëgjoi të rrahurat e këmbëve, tha: O Ebu Hurejre, qëndro aty. Aty dëgjova rrjedhjen e ujit. Ajo u pastrua, veshi këmbëshën, pastaj shpejtoi te mbulesa e saj, e hapi derën dhe tha: O Ebu Hurejre, dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë, përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Menjëherë u ktheva tek i Dërguari i Allahut ﷺ duke qarë nga gëzimi dhe i thashë: O i Dërguari i Allahut, të përgëzoj se Allahu i është përgjigjur lutjes sate dhe e udhëzoi nënën e Ebu Hurejrës, e në atë rast ai e falënderoi

*Allahun, e lavdëroi Atë dhe foli fjalë të mira...*⁴⁷

Lutja që bëri kundër parisë kurejshe

2. Nga Abdullah ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Teksa i Dërguari i Allahut ﷺ ishte ngritur për t'u falur në Qabe, aty në ndejë ishin një grumbull kurejshish. Njëri prej tyre tha: A nuk e shihni këtë që vepron (falet) për sy e faqe. Kush prej jush shkon te deveja e filanit, t'ia marrë zorrët, gjakun dhe mbështjellësin e devesë së porsalindur, që të na e sjellë atë dhe të presë derisa ai të bjerë në sexhde, e atëherë t'ia hedhë mbi supet e tij. U ngrit më i keqi prej tyre. E, kur i Dërguari i Allahut ﷺ bëri sexhde, ia hodhi atë (ndyrësirën) mbi supe. I Dërguari i Allahut ﷺ vazhdoi të qëndronte në sexhde, kurse ata qeshnin, saqë u shtrinë mbi njëri-tjetrin. Dikush e lajmëroi Fatimen, e cila akoma ishte vajzë e re. Ajo shpejtoi, ndërkaq ai rrinte në sexhde, derisa ajo ia largoi atë. Ajo iu drejtua atyre me fyerje, e, kur i Dërguari i Allahut ﷺ e përfundoi namazin, tha: "O Allah, merru me kurejshët (shkatërroji ata)! O Allah, merru me kurejshët! O Allah, merru me kurejshët!" Pastaj përmendi emrat: "O Allah, merru me Amër ibn Hishamin, Utbe ibn Rabian, Shejbe ibn Rabian, Velid ibn Utben, Umeje ibn Halefin, Ukbe ibn Ebu Muajtín dhe Umare ibn Velidin."

Abdullah ibn Mesudi thotë: Beto hem në Allahun se, ditën e Bedrit i kam parë të vrrarë (ata që bëri lutje kundër tyre), të cilët më pas u tërhoqën zvarrë deri te një pus në Bedër...⁴⁸

47 Muslimi (2491).

48 Buhariu (520) dhe Muslimi (1794).

Lutja që bëri për Abdullah ibn Abasin

3. Nga Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: (Një ditë) Profeti ﷺ hyri në banjë, ndërsa unë ia afrova ujin për abdes, e ai pyeti: “Kush e bëri këtë?” Pasi i treguan, tha: “O Allah, shtoja të kuptuarit e fesë!”⁴⁹

Në një motërzim tjetër: “O Allah, mësoja Librin!”⁵⁰

Në motërzimin e tretë qëndron: “O Allah, shtoja të kuptuarit e fesë dhe mësoja komentimin (e Kuranit)!”⁵¹

Allahu i Madhëruar iu përgjigj lutjes së Profetit ﷺ për Abdullah ibn Abasin. Ndonëse ai ishte i ri në moshë, kalifi Omer ibn Hatabi e donte, e afronte dhe konsultojte me të siç vepronte me sahabët e mëdhenj.⁵² Abdullah ibn Mesudi thoshte: Sa përkthyes (njohës i kuptimeve) i mirë i Kuranit që është Ibn Abasi!⁵³

Mesruku thoshte: Kur e shihja Ibn Abasin, thosha: Njeriu më i bukur. Kur fliste, thosha: Më oratori. Kur rrëfente, thosha: Njeriu më i ditur.⁵⁴ Kasim ibn Muhamedi thoshte: Shokët e tij e quanin Det dhe Dijetar (aludonin në diturinë e tij të madhe).⁵⁵

Lutja që bëri për Enes ibn Malikun

4. Enes ibn Maliku transmeton se (nëna e tij) Umu Sulejmi (Allahu qoftë i kënaqur me ta) i ka thënë Profetit ﷺ: Enesi, shërbëtori yt (lutu për të).

49 Buhariu (143) dhe Muslimi (2477).

50 Buhariu (75).

51 Ahmedi (2397).

52 Ibn Abdulberri, El-Istiab, vëllimi 3, f. 935.

53 Ibn Abdulberri, El-istiab, vëllimi 3, f. 935.

54 Ibn Abdulberri, El-istiab, vëllimi 3, f. 935.

55 Ibn Abdulberri, El-istiab, vëllimi 3, f. 936.

Atëherë Profeti ﷺ tha: “O Allah, shtoja pasurinë e fëmijët dhe çoji bereqet në atë që i jep!”⁵⁶

Enesi thoshte: Një fëmijë imi më ka treguar: Nga fëmijët dhe nipat e mi (deri tani) janë varrosur më tepër se njëqind sosh.⁵⁷

Po ashtu thoshte: Asnjë ensar nuk ka pasuri më shumë se unë..⁵⁸

Enesi jetoi gjatë, diku nëntëdhjetë e nëntë vjet⁵⁹.

Lutja kundër atij që nuk iu bind dhe hëngri me të majtën

5. Nga Seleme ibn Ekva (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Një njeri hante me dorë të majtë në prani të të Dërguarit të Allahut ﷺ, andaj i tha atij: “Ha me të djathtën.”

- Nuk mundem, - ia ktheu ai.

- “Mos mundsh, pra”, - i tha Profeti ﷺ.

Pastaj shtoi: “Vetëm mendjemadhësia ishte ajo që e pengoi.”

(Seleme tregon:) Nuk mund ta ngrinte (kafshatën) te goja e tij.⁶⁰

Ky person nuk iu bind Profetit ﷺ, ndërkohë arsyeja e tij ishte shumë e pakuptimtë. Për këtë arsye, pas lutjes së Profetit ﷺ: “Mos mundsh, pra”, nuk mundi ta ngritë dorën e tij deri në gojë.

56 Buhariu (6334) dhe Muslimi (660) më gjerësisht.

57 Ahmed ibn Hanbeli, Fadailus-sahabe, vëllimi 2, f. 847.

58 Ahmed i (12053).

59 Ibn Abdulberri, El-Istiab, vëllimi 1 f. 111.

60 Muslimi (2021).

Lutja për kërkimin e shiut

6. Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Në ditën e premte, një person hyri nga dera që ishte përballë minberit⁶¹, iu drejtua të Dërguarit të Allahut ﷺ, teksa ai ishte në këmbë duke ligjëruar, dhe i tha: O i Dërguari i Allahut, bagëtitë u shkatërruan dhe rrugët janë bllokuar. Prandaj, lute Allahun që të na çojë shi! Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ i ngriti duart dhe tha: “O Allah, na ço shi! O Allah, na ço shi! O Allah, na ço shi!”

Enesi vazhdon duke thënë: Betohem në Allahun se, në qiell nuk kishte asnjë re, asnjë copë reje, e asgjë kësisoj, ndërsa në mes nesh dhe (malit) Sela nuk kishte as shtëpi e as vendbanim. Sakaq, pas malit doli një re sikurse një mburojë, e, kur erdhi në mes të qiellit, u shpërnda dhe e lëshoi shiun. Betohem në Allahun se gjashtë ditë nuk e kemi parë Diellin. Pastaj, në xhumanë vijuese erdhi një njeri nga e njëjta derë, iu drejtua të Dërguarit të Allahut ﷺ, teksa ai ishte në këmbë duke ligjëruar dhe i tha: O i Dërguari i Allahut, pasuritë na u shkatërruan e rrugët na u bllokuan. Prandaj, lute Allahun që ta ndalë. Aty i Dërguari i Allahut ﷺ i ngriti duart dhe tha: “O Allah (bëje të bjerë) përreth nesh, e jo sipër nesh. Në lartësira e në kodra, në pyje e në kodrina, në lugina dhe aty ku mbijnë drunjtë.”

Enesi tregon: Shiu u ndal dhe ne dolëm të ecim në diell.⁶²

Lutja kundër fisit mudarr

7. Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte lutur për disa besimtarë dhe kundër fisit

61 Vend i ngritur në xhami, ku qëndron imami gjatë ligjërimit.

62 Buhariu (1013) dhe Muslim (897).

mudarr duke thënë: “O Allah shpëtoje: Velid ibn Velidin, Seleme ibn Hishamin, Ajash ibn Rabian dhe besimtarët e dobët! O Allah, shtoje dënimin Tënd mbi fisin mudarr dhe bëjua vitet e tyre sikurse vitet e Jusufit (me thatësi të madhe)!”⁶³

Profeti ﷺ u lut për këta besimtarët që ishin në Mekë që t'i shpëtojë prej zullumit të idhujtarëve mekas. Ai u lut ditë të tëra për ta dhe nuk u ndal së luturi derisa Allahu iu përgjigj lutjes së tij.⁶⁴

Ndërkaq, sa i përket lutjes kundër fisit mudarr, ata i goditi thatësi e madhe, sa që hëngrën lëkura dhe ngordhësira, e, kur ndonjëri shikonte qiellin, i dukej tym, nga uria që kishte.⁶⁵

Lutja për udhëzimin e fisit deus

8. Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Tufejl ibn Amri erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: Fisi deus janë shkatërruar, kanë bërë mëkat dhe nuk pranuan (Islamin), andaj lute Allahun kundër tyre. Atëherë ai u lut: “O Allah, udhëzoje fisin deus dhe silli ata.”⁶⁶

Allahu iu përgjigj lutjes së Profetit ﷺ që të udhëzoj fisin deus. Prijësi i fisit deus ishte Habib ibn Amër ed Deusiu, i cili thoshte: Unë e di se krijesat kanë një Krijues, por nuk e di kush është Ai? E, kur dëgjoji për Profetin ﷺ, shkoi tek ai me shtatëdhjetë e pesë persona të tjerë dhe e

63 Buhariu (804) dhe Muslimi (675).

64 Sahih Ibn Huzejme, vëllimi 1, f. 315 dhe Bejhekiu, Delail en-nubuveh, vëllimi 4, f. 176.

65 Ibn Batali, Sherh Sahih el Buhari, vëllimi 3, f. 6.

66 Buhariu (4392).

përqafoi Islamin. Pas tij Islamin e përqafuluan edhe ata që ishin me të.⁶⁷

Lutja për udhëzimin e Omerit

9. *Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “O Allah, shtoja krenarinë Islamit përmes njërit prej këtyre dy burrave që është më i dashur te Ti: përmes Ebu Xhehlit ose Omer ibn Hatabit!”*

*Abdullah ibn Omeri shtoi: Prej tyre, Omeri ishte më i dashur tek Ai.*⁶⁸

Allahu iu përgjigj lutjes së Profetit ﷺ duke e udhëzuar Omerin, me të cilin u forcua Islami dhe muslimanëve iu shtua krenaria. Abdullah ibn Mesudi thoshte: Vazhduam së qeni krenarë, që kur Omeri e pranoi Islamin⁶⁹.

Po ashtu, Ikrime thoshte: Islami ishte i fshehur (mbahej fshehurazi), derisa Omeri e pranoi Islamin (atëherë u forcuan dhe e shprehën haptazi).⁷⁰

Lutja për Seib ibn Jezidin

10. *Nga Seib ibn Jezidi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të këtë thënë: Unë me tezen vajtëm te Profeti ﷺ, e ajo i tha: O i Dërguari i Allahut, djali i motrës sime është sëmurrur.*

67 Fet-hul Bari, vëllimi 8, f. 102.

68 Tirmidhiu (3681), i cili njëherazi e konsideron të saktë, po ashtu e shënon Ahmedi (5696). Ky hadith vjen nga disa rrugë nga Abdullah ibn Omeri, të cilat kanë dobësi, porse ky hadith transmetohet edhe nga Aishja, ku i Dërguari ﷺ ka thënë: “O Allah, shtoja krenarinë Islamit me Omer ibn Hatabin në veçanti.” Hakimi (4485). Andaj, themi se hadithi forcohet me të gjitha këto transmetime.

69 Buhariu (3684).

70 Sijer alam en-nubela, vëllimi 28, f. 72.

Atëherë, ma fërkoj kokën dhe u lut për mua për bereqet, pastaj mori abdes dhe unë piva prej atij uji. Më pas, i shkova pas shpine dhe e pashë vulën profetike në mes dy krahëve, sikurse ve pëllumbi.⁷¹

Në një motërzim, Xhuejd ibn Abdurrahmani tregon: E kam parë Seib ibn Jezidin në moshën nëntëdhjetekatërvjeçare, ishte i fortë e i drejtë (në trup) dhe thoshte: Unë e di se kjo begati në dëgjim dhe në shikim është për shkak të lutjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ, kur tezja ime vajti me mua tek ai dhe i tha: O i Dërguari i Allahut, ky djali i motrës sime është i sëmurë. Andaj, lute Allahun për të. Atëherë ai u lut për mua.⁷²

Lutja për Amër ibn Ahtab Ensariun

11. Nga Amër ibn Ahtab Ensariu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ më tha: “Afrohu.” Kështu, me dorë ma fërkoj kokën dhe mjekrën, pastaj tha: “O Allah, bëje të bukur dhe zgjatja bukurinë!”

Transmetuesi (Azra), në lidhje me Amër ibn Ahtabin, thotë: Mbushi njëqind e disa vjet pa qime te bardha në kokë a mjekër, përpos cave (qimeve). Ishte fytyrëçelur dhe pa rrudha, derisa vdiq.⁷³

Në një motërzim tjetër Amër ibn Ahtab Ensariu thotë: I Dërguari i Allahut ﷺ kërkoi ujë, andaj unë i solla një enë me ujë, ku kishte rënë një qime, por e largova atë, pastaj ia dhashë atij. Atëherë (Profeti ﷺ) u lut: “O Allah, bëje të bukur!”⁷⁴

71 Buhariu (190) dhe Muslimi (2345).

72 Buhariu (3540).

73 Ky hadith ka tri rrugë, të cilat e forcojnë njëra-tjetrën dhe kësisoj ky hadith bëhet i saktë: E para: Ahmedi (20733, 22890) dhe Tirmidhiu (3629), i cili thotë se është hasen garib (i mirë, por vetëm me një rrugë), kurse Bejhekiu (6/211) thotë se është i saktë; e dyta: Ahmedi (22881, 22883); e treta: Ahmedi (22885) dhe Ibn Hibani (7170).

74 Ahmedi (22883).

Lutja për largimin e epidemisë nga Medina

12. Nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Kur i Dërguari i Allahut ﷺ erdhi në Medinë, Ebu Bekri dhe Bilali u sëmurën.

Teksa Ebu Bekrin e kapnin ethet, recitonte:

Çdo person gdhin në familjen e tij,

Porse vdekja është më afër tij se rripi e nallaneve.

Ndërkaq, pasi Bilalit i largoheshin ethet, recitonte me zë të lartë (e qante Mekën):

Ah, sikur të ndieja, që të fle një natë,

Në një luginë ku përreth kam “idhhir” (barishte në Mekë) dhe “xhelil” (bimë në Mekë)

A do të shkoj ndonjë ditë tek uji Mexhine (burim afër Mekës)

Dhe a do t’i shoh kodrat Shame dhe Tafil (afër Mekës)?

Pastaj thoshte: O Allah, mallkoji: Shejbe ibn Rabian, Utbe ibn Rabian dhe Umeje ibn Halefin, ashtu si na larguan prej tokës sonë në tokën me epidemi!

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “O Allah, na e bëj të dashur Medinën, ashtu si e donim Mekën, madje edhe më shumë. O Allah, na jep bereqet në saë⁷⁵ dhe në mud⁷⁶. Na e bëj (Medinën) të shëndetshme dhe largoje epideminë e saj për në Xhuhfe (jashtë Medinës)!”

Aishja thotë: Shkuam në Medinë, që ishte vend më epidemik, ndërkaq lugina But-han: rridhte ujë të prishur (me ngjyrë dhe erë të keqe).⁷⁷

75 Enë matëse, diku 2-3 kg.

76 Dy grushte.

77 Buhariu (1889) dhe Muslimi (1376).

Imam Neveviu thotë: Kjo është një mrekulli profetike e Profetit tonë ﷺ, ngase Xhuhfa prej asaj dite është vend i lënë: S'ka njeri që e pi ujin e saj e të mos e kapin ethet.⁷⁸

Ndërkaq, pas lutjes së Profetit ﷺ që ta largojë epideminë prej Medinës për në Xhuhfe, Medina u bë vendi më i shëndetshëm i Allahut.⁷⁹

Lutja për Xheririn, që të bëhej i qëndrueshëm në kalërim

13. Nga Xherir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet një hadith i gjatë, i cili, mes të tjerash, thotë: “Nuk mund të qëndroja mbi kalë, gjë për të cilën iu ankova Profetit ﷺ. Atëherë, me dorën e tij më goditi në gjoks, saqë e vërejta gjurmën e dorës së tij në gjoksin tim dhe u lut: “O Allah, bëje të qëndrueshëm dhe bëje udhëzues e të udhëzuar.” Xheriri vazhdon: Pas kësaj, kurrë më nuk kam rënë nga kali⁸⁰.

Lutja për Urvën, që ta begatohej në tregti

14. Nga Urve ibn Xhad Bariki (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ më dha një dinar që t'i blej një dele, por unë i bleva dy dele, pastaj njëren e shita për një dinar, kështu që vajta te Profeti ﷺ me një dele dhe me një dinar.

Urve i tregoi se si e bëri këtë. Atëherë Profeti ﷺ u lut për të: “Allahu të begatoftë në tregtinë tënde.”

Pas kësaj ai dilte në tregun Kunase të (qytetit të) Kufes, ku fitonte shumë dhe ishte njëri prej banorëve më të pasur të Kufes⁸¹.

78 Sherh Sahih Muslim (9/150).

79 Fet-hul-Bari, vëllimi 10, f. 191.

80 Buhariu (43570 dhe Muslimi (2475).

81 Ky hadith i ka tri rrugë: E para: Tirmidhiu (1258) dhe teksti i lartpërmendur është i tij; e dyta: Ebu Davudi (3385) dhe Ibn Maxhe (2402); e treta: Buhariu në Sahih (3642), Ebu Davudi (3384), Ibn Maxhe (2402), me tekst të ngjashëm. Transmetimi i Imam Tirmidhiut

Lutja kundër kalorësit që e ndiqte atë

15. Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton një hadith të gjatë të Profetit ﷺ, i cili ishte në arrati rrugës prej Mekës për në Medinë, e të cilin e kërkonin politeistët e Mekës, të gjallë ose të vdekur. Në mes të tjerash i kishte ndodhur edhe kjo:

Teksa Ebu Bekri ishte me të, papritmas u shfaq një kalorës (Suraka ibn Maliku, politeist mekas), i cili i zuri ata. Atëherë tha: O i Dërguari i Allahut, ja një kalorës, na zuri ne. Profeti ﷺ e pa atë dhe tha: “O Allah, rrëzoje atë!”

Sakaq, kali e rrëzoi, pastaj u ngrit duke lëshuar zë.

Ai (kalorësi) tha: O i Dërguari i Allahut, më urdhëro çfarë të duash. “Ndalu këtu dhe mos lejo askënd të na arrijë ne”, - tha Profeti ﷺ.

Enesi vazhdon: Ai (Suraka) paradite e luftoi Profetin ﷺ, kurse pas dite u bë mbrojtës i tij.⁸²

Ndryshim drastik i gjendjes së Suraka ibn Malikut: u nis për ta zënë Profetin ﷺ, që të fitojë një çmim të volitshëm prej politeistëve mekas, mirëpo lutja e Profetit ﷺ kundrejt tij, që të rrëzohej nga kali dhe rrëzimi i tij i atypëratyshëm ia ndryshoi mendjen dhe u bë musliman.

është më i forti. Imam Mundhiri për këtë hadith thotë: Zinxhiri i Tirmidhiut është hasen - i mirë. Imam Neveviu thotë: Zinxhiri i Tirmidhiut është hasen - i mirë, si dhe zinxhirët e tjerë janë hasen, andaj hadithi bëhet i saktë. Po ashtu, Ibn Mulekini e konsideron të mirë. (Ibn Mulakini, El-Bedru el-munir, vëllimi 6, f. 453).

82 Buhariu (3911).

Kapitulli i katërt

Veprat mrekulli

Ky kapitull përfshin vepra të ndryshme profetike, të cilat janë mrekulli dhe thyerje të ligjeve kozmologjike, siç janë: shtimi i ujit, shtimi i ushqimit të paktë, shërimi i sëmundjeve të ndryshme etj.

Shtimi i ujit në Hudejbije

1. Nga Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: Në ditën e Hudejbijes njerëzit ishin etur, ndërsa Profeti ﷺ kishte pranë vetes një enë (lëkure), prej së cilës merrte abdes. Njerëzit shpejtuan nga ai, kurse ai u tha: “Çfarë keni?”

- Nuk kemi ujë as për abdes, as për pije, përveç kësaj që ke ti, - iu përgjigjën.

Atëherë, e futi dorën në enë dhe uji filloi të buronte mes gishtave të tij, sikurse krua. Kështu, ne pimë dhe morëm abdes.

Salim ibn Ebu Xhadi e pyeti Xhabirin: Sa veta ishit?

- Edhe po të ishim njëqind mijë veta, do të na mjaftonte. Në fakt, ishim një mijë e pesëqind, - iu përgjigj Xhabiri.⁸³

Shtimi i ujit, i cili u mjaftoi treqind personave

2. Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Teksa Profeti ﷺ ishte në vendin Zevra (afër tregut në Medinë), i sollën një enë. Ai e futi dorën në enë, sakaq uji filloi të buronte mes gishtave të tij, saqë njerëzit morën abdes.

Katadja e pyeti Enesin: Sa veta ishit?

⁸³ Buhariu (3576).

- *Treqind, ose për afërsisht treqind, - iu përgjigj ai.*⁸⁴

Sa i përket shtimit të ujit, kjo i ngjau disa herë dhe në prani të qindra e më tepër se një mijë personave. Këtu dua të sjell një koment shumë të bukur nga dijetari i njohur musliman, Ebu Nuajm el Asbahani, i cili, duke folur rreth mrekullisë së burimit të ujit në mes gishtave të Profetit ﷺ, thotë: Kjo shenjë është shenja më e çuditshme, mrekullia më e madhe dhe argumenti më i fuqishëm, i cili i ngjasonte mrekullisë së Musait, kur shpërtheu uji prej gurit, pasi e goditi me shkop. Madje, kjo është edhe më mahnitëse. Burimi i ujit në mes mishit dhe eshtrave është më mahnitëse dhe më e madhe sesa burimi i tij prej gurit, sepse guri është bazë prej bazave të ujit, siç është e njohur në shkencë dhe e përmendur në njohuri. Nuk është transmetuar e as që është dëgjuar në kohët e shkuara se uji ka buruar dhe ka shpërthyer nga ndonjë bir i Ademit (njeri) derisa i ndodhi atij (Profetit ﷺ)...⁸⁵

Shtimi i ushqimit në ditën e Hendekut

3. Nga Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: Gjatë gropimit të Hendekut, e pashë Profetin ﷺ se e kishte kapluar uri e madhe. Vajta te gruaja ime dhe i thashë: A ke diç (ushqim), ngase pashë se të Dërguarin e Allahut ﷺ e kishte kapluar uria? Ajo nxori një enë, që kishte një saë⁸⁶ elb. Ne kishim një qengj në shtëpi, të cilin e thera, ndërsa gruaja e bloi elbin, ashtu që ajo e mbaroi kur edhe unë e mbarova. Unë e copëtova atë në tenxhere, kurse ajo më tha: Mos më turpëro para të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe atyre që janë me të. Më pas

84 Buhariu (3572) dhe Muslimi (2279).

85 Ebu Nuajm el Asbahani, Delail en-nubuveh, vëllimi 1, f. 405.

86 Enë matëse, e barabartë me diku 3 kg.

shkova tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i fola fshehurazi: O i Dërguari i Allahut, kemi therur një qengj dhe kemi bluar një saë me elb që e kishim, andaj eja ti dhe disa veta me ty.

Aty Profeti ﷺ thirri me zë të lartë: “O banorët e Hendekut, Xhabiri ka përgatitur ushqim, ejani!”

Ndërkaq, mua më tha: “Mos e largoni tenxheren (nga zjarri) dhe mos e piqni brumin derisa të vij unë.”

Unë shkova te gruaja, kurse i Dërguari i Allahut ﷺ u printe njerëzve, e ajo më tha: U bëfsh kështu e ashtu (solle shumë njerëz, kurse ushqimi nuk mjafton). Unë i thashë: Unë veprova si më the.

Ajo ia nxori brumin, e ai (Profeti) pështyu në të dhe u lut për bereqet, pastaj iu kthye tenxheres, edhe aty pështyu, u lut për bereqet dhe tha: “Thirreni bukëpjekësen, që të gatuajë bukë me mua, e ti nxirr prej tenxheres e mos e largo (nga zjarri).”

(Xhabiri vazhdon:) Ata ishin një mijë, betohem në Allahun se ata hëngrën, saqë edhe lënë (teproi) dhe shkuan, ndërsa tenxherja jonë vlonte siç ishte dhe buka piquej siç ishte.⁸⁷

Të qarët e trungut për të

4. Nga Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: Profeti ﷺ mbante hutben (ligjëronte) mbi një trung. E, kur ia bënë minberin (vend i ngritur), u transferua tek ai. Rrjedhimisht, trungu lëshoi zë (sikur të qante). Kështu, Profeti ﷺ shkoi te trungu dhe e fërkoi me dorë.”⁸⁸

⁸⁷ Buhariu (4102).

⁸⁸ Buhariu (3583).

Guri e përshëndeste me selam

5. *Xhabir ibn Semura (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Unë di një gur në Mekë, i cili më përshëndeste me selam që para profetësisë. Unë e njoh edhe tani.”*⁸⁹

Shërimi i syrit të Aliut

6. *Sehl ibn Sadi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se, ditën e Hajberit Profeti ﷺ ka thënë: “Flamurin do t’ia jap një burri, të cilit Allahu do t’i japë fitore.”*

Secili prej shokëve të tij u gdhi duke pritur se kujt do t’ia japë flamurin. Pastaj Profeti ﷺ pyeti: “Ku është Aliu?”

- Ka dhimbje në sy, - i thanë.

Kërkoi ta thërrasin (Aliun). E, kur erdhi, Profeti ﷺ ia fërkoj dy sytë me pështymë, sakaq u shërua sikur të mos kishte gjë...⁹⁰

Kuptimi i gjuhës së devesë

7. *Nga Abdullah ibn Xhaferi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ më hipi prapa tij (mbi kafshë) dhe më rrëfeu diç, por nuk do t’i tregoj askujt. Ai (kur dilte) për nevojat e tij, kishte dëshirë të fshihej pas ndonjë gjëje të ngritur ose ndonjë grumbulli palmash. Një ditë, hyri në një kopsht ensarësh, kur ja, një deve iu afrua atij duke lëshuar zë (ankese), saqë edhe sytë i lotuan. Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ ia fërkoj shpinën dhe kokën, derisa u qetësua. Aty pyeti: “Kush është pronari i devesë?”*

Një djalosh ensar erdhi dhe tha: Imja është, o i Dërguari i Allahut ﷺ.

89 Muslimi (2277).

90 Buhariu (2942).

“A nuk e ke frikë Allahun për këtë kafshë, të cilën Ai ta ka lënë në pronësi. Ajo m'u ankua se ti po e lë të uritur dhe po e lodh”, - i tha Profeti ﷺ.⁹¹

Shërimi i devesë së ngadalshme

8. Nga Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: Isha në një udhëtim me Profetin ﷺ dhe kisha një deve të ngadalshme, e cila ishte në fund të karvanit. Profeti ﷺ kaloi pranë meje dhe pyeti: “Kush është?”

- Xhabir ibn Abdullahu, - iu përgjigja.

- “Çka ke?” - më pyeti.

- Unë jam me deve të ngadalshme, - iu përgjigja.

- “A ke shkop?” - pyeti.

- Po, - i thashë.

- “Ma jep atë”, - më tha.

Unë ia dhashë, e ai e goditi dhe e trembi devenë, saqë prej aty doli e para në karvan...⁹²

Shërimi i Xhabirit me një spërkatje të ujit të abdesit

9. Nga Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmetohet të ketë thënë: Profeti ﷺ dhe Ebu Bekri erdhën në këmbë për të më vizituar te fisi beni seleme. Profeti ﷺ më gjeti pa vetëdije, e në atë rast kërkoi ujë, mori abdes prej tij dhe më pas më spërkati. Aty u kthjella dhe i thashë: Çka më porosit të bëj me pasurinë time, o i Dërguari i Allahut?

Atëherë zbriti (ajeti): “Allahu ju urdhëron për fëmijët tuaj (për

91 Ebu Davudi (2549), Ahmedi (1745) dhe Hakimi (2485), i cili e konsideron të saktë.

92 Buhariu (2309).

trashëgimi)⁹³...⁹⁴

Largimi i dyshimeve të Ubej ibn Kabit

10. Nga Ubej ibn Kabi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Teksa isha në xhami, hyri një njeri dhe u fal, porse lexoi (Kuran) me një lexim për të cilin e qortova. Pastaj, hyri një person tjetër, i cili lexoi ndryshe nga shoku i tij. Pasi mbaruam namazin, shkuam së bashku tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i thashë: Ky lexoi me një lexim për të cilin e qortova, pastaj hyri tjetri dhe lexoi ndryshe nga shoku i tij. Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ i urdhëroi të lexojnë dhe, pasi lexuan, ua aprovoi të dyve. (Ubeji thotë:) Aty në vete më erdhi një përgënjeshttrim (cytje e djallit), sikurse në kohën e injorancës. E, kur i Dërguari i Allahut ﷺ pa çfarë më kishte kapluar, më goditi në gjoks, kurse mua më mbuluan djersët dhe (më erdhi bindja) sikur e shihja Allahun, prej frikës...⁹⁵

Sad ibn Ebu Vekasi e ndiente në vazhdimësi freskinë e dorës së tij

11. Nga Sad ibn Ebu Vekasi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Teksa isha në Mekë, u sëmura rëndë, andaj Profeti ﷺ erdhi të më vizitojë, e unë i thashë: O i Dërguar i Allahut, unë kam lënë pasuri, kurse trashëgimtar kam vetëm një vajzë, andaj po lë testament (lëmoshë) dy të tretat e pasurisë, kurse një të tretën (për vajzën).

- “Jo”, - më tha ai.
- Po e lë testament gjysmën, e gjysmën jo, - i thashë.
- “Jo”, - më tha ai.
- Po e lë testament një të tretën, kurse dy të tretat për vajzën, - i thashë.

93 En Nisa, 11.

94 Buhariu (4577) dhe Muslimi (1616).

95 Muslimi (820).

- “Një të tretën, madje edhe një e treta është shumë”, - më tha ai.

Pastaj e vendosi dorën në ballë, e fërkoj me dorë fytyrën dhe barkun tim, pastaj tha: “O Allah, shëroje Sadin dhe plotësoja hixhretin (të kthehet prapë në Medinë).”

(Sadi thoshte:) Vazhdoj ta ndiej freskinë e dorës së tij - siç e paramendoj - në mëlçinë time deri në këtë moment.⁹⁶

Ndodhia e Ebu Hurejrës, që të mos e harrojë hadithin profetik

12. Nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se i ishte drejtuar Profetit ﷺ me këto fjalë: O i Dërguari i Allahut ﷺ, unë po dëgjoj shumë hadithe prej teje, por po i harroj.

- “Shtriye rrobën tënde (të sipërme)”, - më tha ai.

Unë e shtriva atë, kurse ai e futi dorën në të, pastaj tha: “Mblidhe atë.”

Unë e mblodha, e pas kësaj nuk kam harruar asgjë⁹⁷.

Ibn Haxheri, duke numëruar dobitë e këtij hadithi, tregon: “Një mrekulli të qartë që është prej shenjave profetike, ngase harresa është pjesë e pandashme e njeriut, saqë Ebu Hurejra e pranonte se harronte shumë, por më pas asgjë nuk harroi, për shkak të bereqetit të Profetit ﷺ.”⁹⁸

Dhekvan Seman Ebu Salihu thoshte: Ebu Hurejra ishte në mesin e sahabëve që dinte më së shumti hadithe përmendsh⁹⁹.

Po ashtu, imam Shafiu thoshte: Në kohën e tij, në mesin e atyre që transmetonin hadithe, Ebu Hurejra ishte ai që dinte më së shumti

⁹⁶ Buhariu (5659).

⁹⁷ Buhariu (119) dhe Muslimi (2492) më gjerësisht.

⁹⁸ Fet-hul Bari, vëllimi 1, f. 215.

⁹⁹ Sijer alam en-nubela, vëllimi 2, f. 597.

përmendsh¹⁰⁰.

I sëmuri u ndëshkua pasi kundërshtoi optimizmin e tij

13. Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta) transmeton se një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ vizitoi një të sëmure, të cilit i tha: “(Tahur, la bese inshallah) Pastrim, në dashtë Allahu, s’ka dëm.”

Ai tha: The: Pastrim?! Assesi, por janë ethe që vlojnë, te një i vjetër, që e bëjnë t’i vizitojë varrezat.

Kurse Profeti ﷺ ia ktheu: “Mirë, atëherë!”¹⁰¹

Profeti ﷺ i mësonte njerëzit që të ishin optimistë në çdo sferë të jetës, sidomos në sëmundje. Këtë njeri e mësoi se kjo ishte vetëm pastrim mëkatesh dhe, në dashtë Allahu, të ishte kaluese e të mos kishte dëm më tepër, porse ky person ishte shumë pesimist dhe nuk e mori këshillën profetike, rrjedhimisht e gjeti atë që deshi.

Këtë na e sqaron një transmetim tjetër, ku qëndron se Profeti ﷺ i tha atij: “Nëse nuk do, atëherë ajo do të bëhet siç thua ti, caktimi i Allahut do të ndodhë.” Mbrëmja e së nesërme e zuri të vdekur.¹⁰²

100 Sijer alam en-nubela, vëllimi 2, f. 599.

101 Buhari (3616), në kapitullin “Profecitë” (En-nubuvat), ndoshta vetëm me këtë transmetim nuk kuptohet qartë profecia, porse kjo shihet qartë në një rrugë tjetër të hadithit; Fet-hul Bari, vëllimi 6, f. 625.

102 Taberaniu (7213), me zinxhir të dobët, porse Ibn Haxheri (Fet-hul Bari, vëllimi 10, f. 119) përmend edhe një transmetim tjetër të dobët, të cilin e transmeton Abdurrezaku, kësh-tu që të dyja transmetimet forcohen mes vete.

Shpëtimi nga atentati përmes deles së helmuar

14. Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet të ketë thënë: Një grua çifute i solli Profetit ﷺ një dele të helmuar, e ai hëngri prej saj. Më pas e sollën atë grua te Profeti ﷺ dhe ai e pyeti për këtë, kurse ajo iu përgjigj: Doja të të vrisja.

Atëherë ai ia ktheu: “Allahu nuk të ka dhënë pushtet mbi mua.”¹⁰³

Imam Neveviu thotë: Nga ky hadith kuptojmë se Profeti ﷺ ishte i mbrojtur prej (dëmit të) njerëzve, ashtu siç ka thënë Allahu: “**Allahu të mbron prej njerëzve.**”¹⁰⁴ Kjo është mrekulli e Profetit ﷺ, ngase ai i shpëtoi helmit, i cili i vret të tjerët dhe se Allahu i Madhëruar e lajmëroi atë se ajo ishte e helmuar...¹⁰⁵

103 Buhariu (2617) dhe Muslimi (2190), teksti është i këtij të fundit.

104 El Maide, 67.

105 Sherh Sahih Muslim, vëllimi 14, f. 179.

Kapitulli i pestë

A janë ndryshuar hadithet apo thëniet e tij?

Dikush mund të pyesë: Tërë kjo që lexuam është shumë e bukur, por, si të bindemi se kjo që ne lexuam është e vërtetë? A ka mundësi që dikush të ketë trilluar diç dhe t'ia atribuojë profetit Muhamed ﷺ?

Përgjigjja: Shkenca e hadithit është shkencë e mrekullueshme, e cila merret me studimin e fjalëve, veprave, pëlqimeve dhe virtyteve të profetit Muhamed ﷺ.

Tërë Hadithi është shpallje që ka ardhur si sqarim i Kuranit fisnik, andaj është dashur të bëhet kujdes i veçantë nga ana e dijetarëve, që të dihet çështje e vërtetë prej asaj që është e fabrikuar ose e trilluar në lidhje me Hadithin profetik.

Në këtë mënyrë, dijetarët e hadithit kanë vënë rregulla precize dhe kushte të rënda për të pranuar një hadith si të vërtetë ose, thënë ndryshe, për të vërtetuar se kjo fjalë a vepër është një e dhënë e saktë historike nga profeti Muhamed ﷺ.

Kësisoj, hadithi duhet të ketë zinxhir të transmetuesve. Pra, duhet të dihet kush e ka dëgjuar prej Profetit ﷺ ose kush e ka parë atë. Pastaj, ky person kujt ia ka treguar këtë hadith dhe, në këtë mënyrë, person pas personi, deri tek autorët e parë të librave përmbledhës të haditheve profetike.

Në këtë pikë është shumë e rëndësishme njohja e datave të vdekjes së transmetuesve, ashtu që të dihet saktësisht kush me kë është takuar dhe pohimi se filan transmetuesi (nxënësi) është takuar me filan transmetuesin (mësuesin). Në të kundërtën, hadithi nuk pranohet nëse ka shkëputje diku në mes të këtyre transmetuesve.

Duhet të dihet saktësisht jeta e këtyre personave, emri, mbiemri, fisi

e jeta e tij. Duhet të jetë njeri i cili është i njohur për fetar, që i kryen obligimet dhe u largohet mëkateve, që është i besueshëm e i sigurt. Duhet të dihet nëse ka gënjyer ndonjëherë për çështje të dynjasë, aq më shumë për shpifje ndaj Profetit ﷺ.

Po ashtu, shikohet aftësia e tij e mbajtjes në mend, memorimi i hadithit dhe shënimet (shkrimi i hadithit) te çdo transmetues, veç e veç, a e kanë ruajtur ashtu siç e ka thënë Profeti ﷺ; a kanë shtuar apo kanë lënë mangët diç; apo mos kanë bërë ndryshime në tekst. Tërë kjo është bërë me një precizitet mahnitës, me të dhëna të sakta, duke bërë krahasime mes transmetimeve dhe analiza të thukëta përkitazi me to.

Shpeshherë dijetarët e hadithit e testonin njëri-tjetrin se sa e ka të fuqishme memorien dhe sa i ka të sakta shënimet e haditheve që i shkruante.

Gjithë këto gjëra janë regjistruar mirë dhe ka libra të tërë që flasin për çdo pikë prej këtyre pikave që i përmenda më lart. Sa për ilustrim, po sjell një shembull të thjeshtë, pa u zgjeruar shumë, se si bëhet kontrollimi dhe saktësimi i një hadithi profetik:

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kush gënjen ndaj meje qëllimisht, le ta përgatisë kolltukun e tij prej Zjarri.”¹⁰⁶

Këtë hadith nga i Dërguari i Allahut ﷺ e ka dëgjuar Ebu Hurejra. Ebu Hurejra këtë hadith ia ka treguar Ebu Salihut. Ebu Salihu këtë hadith ia ka treguar Ebu Husajnit. Ebu Husajni këtë hadith ia ka treguar Ebu Avanes. Ebu Avane këtë hadith ia ka treguar Musa ibn Ismailit. Musai këtë hadith ia ka treguar imam Buhariut, i cili e ka shkruar në librin më të saktë të haditheve profetike në “Sahihul Buhari”.

Tani ky zinxhir i transmetuesve duhet shikuar një nga një: cilët janë, sa ishin të besueshëm e të saktë, a janë takuar mes vete, a kanë gabuar diç?

106 Buhariu (110).

Ebu Hurejra

Ishte sahabiu që më së shumti ka transmetuar hadithe profetike, kishte memorie të veçantë, natë e ditë qëndronte pranë Profetit ﷺ. Hadithet që i transmetonte ia recitonte Aishes, gruas së Profetit ﷺ, ndërsa ajo ia aprovonte se ishin në rregull¹⁰⁷.

Abdullah ibn Omeri iu drejtua Ebu Hurejrës me këto fjalë: “Ti ke qëndruar më së tepërmi me Profetin ﷺ dhe je më i dituri në lidhje me hadithet e tij.”¹⁰⁸

Më tepër se tetëqind persona, qoftë shokë, qoftë nxënës, kanë transmetuar prej tij¹⁰⁹.

Ebu Salihu

Emri i plotë i tij ishte: Dhekvan es Semani. Dijetarët e hadithit, si: Jahja ibn Meini, Ebu Zura, Ebu Hatimi e Ahmed ibn Hanbeli për të thonë se është i besueshëm dhe i saktë në transmetimin e haditheve profetike¹¹⁰.

Ebu Husajni

Emri i plotë i tij ishte: Othman ibn Asim el Ezdiu. Dijetarët e hadithit, si: Abdurrahman ibn Mehdiu, Jahja ibn Meini e Ahmed ibn Hanbeli për të thonë se është i besueshëm dhe i saktë¹¹¹.

Ebu Avane

Emri i plotë i tij ishte Veda ibn Abdullah el Jeshkuriu. Dijetarët e hadithit, si: Ebu Zura, Ebu Hatimi, Ahmed ibn Hanbeli janë të mendimit: Nëse hadithet i transmeton Vedai prej librit të tij, atëherë është i besueshëm dhe i saktë¹¹².

Musa ibn Ismail el Minkariu

107 Sijer alam en-nubela, vëllimi 2, f. 607.

108 El-Isabeh, vëllimi 7, f. 358.

109 El-Istiab, vëllimi 4, f. 1771.

110 Tehdhib el-kemal, vëllimi 8, f. 516.

111 Tehdhib el-kemal, vëllimi 19, f. 403.

112 Tehdhib el-kemal, vëllimi 30, f. 446-447.

Dijetarët e njohur, si: Jahja ibn Meini, Muhamed ibn Sadi e Ebu Hatim er Razi për të kanë thënë se është i besueshëm dhe i saktë në transmetimin e hadithit¹¹³.

Imam Buhariu

Emri i plotë i tij ishte: Muhamed ibn Ismail el Buhariu, autori i librit më të saktë të haditheve, që i mori gjashtëmbëdhjetë vjet derisa e përfundoi së shkruari¹¹⁴.

Për këtë dijetar nuk ka nevojë të sjellim lëvdatat e dijetarëve, ngase historia islame ka dëshmuar për diturinë, saktësinë, precizitetin dhe besueshmërinë e tij në hadith.

Imam Buhariu tregon dy gjëra shumë me rëndësi rreth librit të tij “Sahihul Buhari”, i cili i ka 7563 hadithe profetike:

E para: Këtë libër e kam përmbledhur prej më se gjashtëqind mijë hadithesh.

E dyta: Në këtë libër kam futur vetëm atë që është e saktë...¹¹⁵

Së këndejmi, themi: Rezultati përfundimtar del se hadithi profetik: “Kush gënjen ndaj meje qëllimisht, le ta përgatisë kolltukun e tij prej Zjarri” është i saktë, ngase i plotëson kushtet e hadithit të pranuar dhe për këtë arsye e kanë saktësuar dijetarët dhe kolosët e shkencës së hadithit.

Këtij rezultati i shtohet edhe diç tjetër, që është: Të njëjtin hadith nga Profeti ﷺ e kanë dëgjuar edhe shokët e tij të tjerë, si: Mugire ibn Shube, Abdullah ibn Amri, Ebu Seid Hudriu etj., të cilët ua transmetuan brezit që erdhi pas tyre deri te koleksionet e sakta të haditheve profetike.

Pra, themi se ky hadith saktësohet përmes shumë rrugëve të transmetimit deri te Profeti ﷺ.

113 Tehdhib el-kemal, vëllimi 29, f. 25.

114 Sijer alam en-nubela, vëllimi 12, f. 405.

115 Tarih Bagdad, vëllimi 2, f. 9.

Kapitulli i gjashtë

Dëshmi interesante rreth Profetit ﷺ

1. Këtë kapitull po e filloj me një dialog shumë të bukur dhe shumë logjik, në mes dy njerëzve të mëdhenj të asaj kohe, njëri ishte i krishterë, mbret romak, që njihej me emrin Herakli, kurse i dyti ishte politeist mekas, prijës i fisit kurejsh, armik i përbetuar i Profetit ﷺ, i cili quhej Ebu Sufjan ibn Harbi, porse në vitin e Çlirimit të Mekës e përqafoi Islamin.

Ja dialogu:

Ebu Sufjani tregon se Herakliu i shkroi atij teksa ishte me një grup kalorësish tregtarë të fisit kurejsh, që kishin ardhur në Sham. Në këtë kohë Profeti ﷺ ishte në marrëveshje me Ebu Sufjanin dhe politeistët kurejshë. Ndërsa ishin në qytetin Ilija (Kuds), ata vajtën te Herakliu, i cili i ftoi në ndejën e tij, kurse përreth kishte elitë romake, pastaj i thirri ata, i thirri edhe përkthyesit dhe tha: Cili prej jush është më i afërti me prejardhje me këtë njeri i cili pretendon se është profet?

- Unë jam më i afërti me të me prejardhje, - iu përgjigj Ebu Sufjani.

Herakliu tha: Afrojeni atë tek unë, kurse shokët e vet lërini pas shpinës së tij.

Pastaj përkthyesit i tha: Thuaju atyre që, nëse ky gënjen, ta përgënjeshtrojnë atë.

Ebu Sufjani shtoi: Beto hem në Allahun se, sikur të mos ishte turpi se do të më thoshin gënjeshtar, do të gënjeja.

Pyetja e parë që ma bëri (Herakliu) ishte:

- Çfarë prejardhjeje ka te ju?

- Është me prejardhje fisnike, - iu përgjigja.

- A e ka pretenduar kush këtë gjë para tij? - pyeti ai.

- Jo, - iu përgjigja.
 - A kishte ndonjë mbret prej baballarëve të tij? - pyeti.
 - Jo, - iu përgjigja.
 - A e pasojnë atë njerëzit me pozitë apo të dobët? - pyeti.
 - Të dobët, - iu përgjigja.
 - Shtohen apo pakësohen? - pyeti.
 - Shtohen, - iu përgjigja.
 - A bëhet renegat kush, duke e urryer fenë, pasi ka hyrë në të? - pyeti.
 - Jo, - iu përgjigja.
 - A e keni akuzuar për gënjeshtëri para se të thoshte këtë që e thotë? - pyeti.
 - Jo, - iu përgjigja.
 - A tradhton? - pyeti.
 - Jo, porse ne jemi në marrëveshje me të, e nuk e di çfarë vepron, - iu përgjigja. (Ebu Sufjani shton:) Kjo ishte e vetmja fjali që kisha mundësi të fusja.
 - A e keni luftuar atë? - pyeti.
 - Po, - iu përgjigja.
 - Si ishte lufta juaj ndaj tij? - pyeti.
 - Lufta mes nesh dhe tij ishte me kthim: Herë fitonte ai, herë fitonim ne, - iu përgjigja.
 - Çfarë ju urdhëron? - pyeti.
 - Ai thotë: Adhurojeni vetëm Allahun, mos i bëni shok Atij dhe lërin çfarë thonë baballarët tuaj. Na urdhëron namazin, zekatin, sinqeritetin, ndershmërinë dhe lidhjen fafërisnore, - iu përgjigja.
- Herakliu i tha përkthyesit: Thuaji atij:
- Të pyeta për prejardhjen e tij, e ti the se është me prejardhje fisnike. Kështu është puna e profetëve: dërgohen në familjen më të mirë të popullit.
 - Të pyeta: A e ka pretenduar kush këtë gjë prej jush, e ti the se jo. Unë

po them se, sikur të pretendonte dikush këtë gjë para tij, do të thosha se pasuaka dikë që ka thënë para tij.

- Të pyeta: A kishte ndonjë mbret te baballarët e tij, e ti the se jo. Unë po them se, sikur të kishte prej baballarëve të tij mbret, do të thosha se kërkuaka mbretërinë e babait.

- Të pyeta: A e akuzonit për gënjeshtër para se të thoshte këtë që po e thotë, e ti the se jo. Unë po them se, nuk ka mundësi që t'i shmanget gënjeshtres ndaj njerëzve e të gënjejë ndaj Allahut.

- Të pyeta: A e pasojnë njerëzit me pozitë apo të dobët, e ti më the se e pasojnë të dobët. Këta janë pasuesit e profetëve.

- Të pyeta: A shtohen apo pakësohen, e ti më the se shtohen. Kështu është çështja e besimit, derisa të plotësohet.

- Të pyeta: A bëhet renegat kush, duke e urryer fenë, pasi ka hyrë në të, e më the se jo. Kështu është besimi, kur ëmbëlsia e tij mishërohet në zemra.

- Të pyeta: A tradhton, e ti më the se jo. Kështu janë profetët: Nuk tradhtojnë.

- Të pyeta: Çfarë ju urdhëron, e ti the se ju urdhëron që ta adhuron Allahun, e të mos i bëni shok Atij. Ju ndalon nga adhurimi i idhujve, ju urdhëron namazin, sinqeritetin dhe ndershmërinë.

(Herakliu e përfundoi dialogun duke thënë:) Nëse është e vërtetë kjo që po thua ti, së shpejti do ta sundojë edhe këtë vend poshtë këmbëve të mia. E dija se ai do të dilte, por nuk mendoja se do të ishte prej jush. Sikur të dija se do të arrija tek ai, do të përpiqesha që ta takoja, e, sikur të isha tek ai, do t'ia pastroja këmbët...¹¹⁶

2. Abdullah ibn Selami ishte hebre i Medinës, njeri i mençur dhe dijetar i tyre. Ai na përshkruan një ngjarje shumë të bukur në lidhje me Profetin

¹¹⁶ Buhariu (7) dhe Muslimi (1773).

ﷺ, që e kishte përjetuar para se ta pranonte Islamin, mu në momentet e para pasi arriti prej Mekës në Medinë, ku rrëfen: Kur i Dërguari i Allahut ﷺ erdhi në Medinë, njerëzit vajtën tek ai. Ata thoshin: Ka ardhur i Dërguari i Allahut ﷺ. Kështu, unë vajta me njerëzit, që ta shihja atë. Pasi e analizova fytyrën e të Dërguarit të Allahut ﷺ, kuptova se fytyra e tij nuk ishte fytyrë gënjeshtari.

Gjëja e parë të cilën e tha, ishte: “O ju njerëz, përhapeni selamin, jepni ushqim dhe faluni, kur njerëzit janë duke fjetur, do të hyni në Xhenet me selam.”¹¹⁷

Ndalu te kjo fjali e tij: “Pasi e analizova fytyrën e të Dërguarit të Allahut ﷺ, kuptova se fytyra e tij nuk ishte fytyrë gënjeshtari.” Kjo fjali buron prej një njohësi të mirë të citateve të Tevratit, një njohësi të mirë të profetëve, në bazë të njohurive që kishte. Po ashtu, shikoje vetëbesimin e tij, që të shkojë e të shohë kush ishte ky njeri, t’ia analizojë fytyrën mirë, që të arrijë deri te një përfundim madhështor: Pranimi i së vërtetës.

3. Orientalisti i njohur amerikan, Vashtington Irving (1783-1859), në librin e tij “Jeta e Muhamedit” thotë: Qëndrimi i Profetit (ﷺ) gjatë Çlirimit të Mekës aludon se ai është Profet i dërguar, e nuk është udhëheqës despot. Aty shfaqti mëshirën dhe butësinë ndaj vendasve të tij. Edhe pse tani ishte në pozitën e të fortit, ai e kurorëzoi suksesin dhe fitoren e tij me mëshirë e falje¹¹⁸.

4. Autori francez Emile Dermenghem (1892-1971), në librin e tij “Jeta

117 Tirmidhiu (2485) dhe Ibn Maxhe (1334). Tirmidhiu thotë: Ky hadith është i saktë.

118 Imadudin Halili, Kalu anil-Islam, f. 95.

e Muhamedit”, thotë: Muhamedit (ﷺ) i lindi djali, Ibrahim, i cili vdiq i vogël. U mërzit për të, e varrosi me dorën e vet dhe qau për të. Rastisi që vdekja e tij të përputhej me eklipsin e Diellit, sa që disa muslimanë thanë: Eklipsi u bë për vdekjen e tij (Ibrahimit), mirëpo Muhamedi (ﷺ) me shpirtmadhësinë e tij e kundërshtoi këtë duke thënë: “Dielli dhe Hëna janë dy shenja prej shenjave të Allahut. Eklipsi i tyre nuk ndodh për shkak të vdekjes së dikujt...”

(Emile Dermenghem vazhdon:) E fjalët e tilla nuk mund të burojnë nga një gënjeshtar, mashtrues...¹¹⁹

5. Autorja skoceze, Evelyn Kobold (1867-1963), e cila më pas u konvertua në Islam, në librin e saj “Hulumtim drejt Zotit” thotë: Arabët para Muhamedit ﷺ ishin popull i pavlerë. Po ashtu, fiset dhe grupet e tyre ishin të parëndësishme. Kur erdhi Muhamedi ﷺ, e rizgjoi këtë popull, rizgjim ky i cili mund të numërohet më afër mrekullive, me të cilin e mposhti botën dhe e udhëhoqi atë, gjeneratë pas gjenerate¹²⁰.

6. Shkencëtari amerikan, Majkëll Hart (1932), në librin e tij “100: Renditja e personave më me influencë në histori”, thotë: Zgjedhja e Muhamedit (ﷺ) që të jetë i pari në listë, e cila përmbledh personat me më ndikim në botë. Ndoshta kjo habit shumë lexues..., porse ai (Muhamedi ﷺ) ishte njeriu i vetëm në histori i cili arriti me sukses në mënyrën më superiore që t’ia dalë në të dyja fushat: Në atë fetare dhe jofetare¹²¹.

119 Po aty, f. 103.

120 Imadudin Halil, Kalu anil-Islam, f. 129.

121 Po aty, f. 141.

Përfundim

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili ma lehtësoi përfundimin e këtij libri, pastaj lavdërimi, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi vulën e profetëve, Muhamedin ﷺ si dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij.

Në fund do të sjell disa mësimë në lidhje me temën e këtij libri:

1. Çdo besimtar e ka obligim ta dojë dhe ta pasojë profetin Muhamed ﷺ, gjë e cila arrihet vetëm duke e njohur dhe duke pasur besim të plotë në të.
2. Qëllimi i këtij libri është shtimi i besimit në Profetin ﷺ, shtimi i dashurisë për të, rrjedhimisht pasimi i tij, ngase besimi në të, pa e pasuar atë, është sikurse pema që nuk jep fruta.
3. Ne nuk kemi pasur fatin të jetojmë me Muhamedin ﷺ, porse mundësia ta njohim atë, të shoqërohemi me të, ta kemi afër mendjeve tona është shumë e lehtë, ngase ai gjendet në libra. Çdo gjë përkritazi me të është regjistruar: Fjalët, veprat, edukata, sjella, gjumi, pastërtia, të ecurit, fizionomia..., sikurse të ishte ende gjallë. Së këndejmi, meqë jemi privuar nga takimi i drejtpërdrejtë me të, të mos privohemi nga njohja e tij.
4. Historia njerëzore nuk ka arritur të shënojë çdo gjë të çdo njeriu, porse ka shënuar për njerëz të mëdhenj dhe për gjëra e ndodhi të mëdha, ndryshe nga Muhamedi ﷺ, ngase çdo gjë e tij është shkruar, qoftë e madhe, qoftë e vogël, mrekulli dhe jo mrekulli, saqë janë përshkruar edhe forma e unazës që mbante, lloji i rripit të nallaneve të tij, gjërat që i pëlqente në ushqim, numri i qimeve të thinjura në kokë e mjekër, dhe kjo në vetvete është mrekulli profetike, e cila meriton të meditohet.

5. Për fund, nuk na mbetet tjetër, pos të themi atë që e ka thënë shërbëtori i Muhamedit ﷺ, Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili rrëfen: *Një njeri e pyeti Profetin ﷺ për Kiametin, duke thënë: Kur është Kiameti?*

- “Çfarë ke përgatitur për të?” - ia ktheu Profeti ﷺ.

- Asgjë, përpos se e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij, - iu përgjigj ai.

Atëherë Profeti ﷺ tha: “Ti do të jesh me ata që i do.”

Enesi vazhdon: *Me asgjë nuk jemi gëzuar më shumë se me fjalën e Profetit ﷺ: “Ti do të jesh me ata që i do.”*

Fjalën e kam për këtë fjali të Enesit: *Unë e dua Profetin ﷺ, Ebu Bekrin e Omerin dhe shpresoj të jem me ta, për shkak të dashurisë sime ndaj tyre, edhe pse nuk kam bërë vepra (të mira) sikurse ata.*¹²²

Së këndejmi, as ne nuk kemi vepra sikurse ata, porse shpresojmë të jemi në shoqërinë e tyre, për shkak të dashurisë sonë që kemi për ta.

¹²² Buhariu (3688) dhe Muslimi (2639).

Literatura

- Ahmed ibn Husejn el-Bejhekiu, *Delail en-nubuveh*, viti 1985 h, Darul-kutub el-Ilmijeh;
- Ebu Nuajm el Asbahani, *Delail en-nubuveh*, viti 1986, Dar en-Nefais;
- Omer ibn Ali ibn Mulakini, *El-Bedru el-munir*, viti 2004, Darul-hixhrah;
- Ismail ibn Omer ibn Kethiri, *El-bidajeh ven-nihajeh*, viti 1988, Dar Ihja et-turath el-arabij;
- Dr. Ali el Gamidi, *El-Harb bejne er-rum vel-furs, fi dau-i suret er-Rum*, viti 2015;
- Ibn Haxher el Askalani, *El-Isabeh fi tmjizi es-sahabeh*, viti 1415 h, Darul-kutub el-ilmijeh;
- Ibn Omer ibn Abdulberri, *El-Istiab*, viti 1992, Darul-xhil;
- Ebu Zekerija Jahja ibn Sheref en Neveviu, *El-Minhaxh Sherh Sahih Muslim ibnul-Haxhaxh*, viti 1392 h, Dar Ihja et-Turath el-Arabij;
- Ebu Abdullah el Hakim en Nejsaburiu, *El-Mustedrek*, viti 1990, Darul-kutub el-ilmijeh;
- Sulejman ibn Ahmed et Taberaniu, *El-Muxhem el-kebir*, Mektebetu Ibn Tejmije;
- Mustafa es Sibai, *Es-Sunneh ve mekenetuha fit-teshri el-islamij*, viti 1426 h, Darul-Verrak;
- Ahmed bin Hanbeli, *Fadailus-sahabe*, viti 1983, Muesesetu er-Risaleh;
- Ibn Haxher el Askalani, *Fet-hul Bari*, viti 1379, Darul-Marifeh;
- Imadudin Halili, *Kalu anil-Islam*, viti 1992, En-Nedveh el-Alemijeh lish-shebab el-Islamij;
- Ali ibn Ebu Bekër el Hejthemiu, *Mexhme ez-zevaid*, viti 1994, Mektebetu el-Kudsij;

Shemsudin edh Dhehebi, *Mizanul-itidal*, viti 1963, Darul-Marifeh;
Musned Ahmed ibn Hanbel, viti 2001, Muesesetu er-Risaleh;
 Shihabudin Jakut el Hameviu, *Muxhem el-Buldan*, viti 1995, Dar Sadir;
 Muhamed ibn Ismail el Buhari, *Sahihul Buhari*, viti 2011, Tuvejik lin-
 neshri vet-tevzi;
Sahih Ibn Hiban el-Bustij, viti 1988, Muesesetu er-Risaleh;
 Muhamed ibn Is'haku, *Sahih ibn Huzejme*, viti 2003, El-Mekteb el-
 Islamij;
 Muslim ibn Haxhaxhi, *Sahih Muslim*, Dar Ihja et-turath el-arabij;
 Shemsudin edh Dhehebi, *Sijer alam en-nubela*, viti 1985, Muesesetu
 er-Risaleh;
 Sulejman ibn Eshathi, *Sunen Ebi Davud*, El-Mektebe el-asrije;
Sunen ibn Maxheh el-Kazvini, viti 2009, Darul-risaleh el-Alemijeh;
 Muhamed ibn Isai, *Sunen et-Tirmidhi*, viti 1998, Dar el-garb el-islamij;
 Ali ibn Halef ibn Batali, *Sherh Sahih el Buhari*, viti 2003, Mektebetu
 er-Rushd;
 El Hatib el Bagdadi, *Tarih Bagdad*, viti 2002, Dar el-Garb el-Islamij;
 Shemsudin edh Dhehebi, *Tarih el-Islam*, viti 2003, Dar el-Garb el-
 Islamij;
 Jusuf ibn Abdurrahman el Miziu, *Tehdhib el-kemal*, viti 1980, Muesesetu
 er-Risaleh;
 Ibn Haxher el Askalani, *Tehdhib et-tehdhib*, viti 1326 h, Matbaatu
 Dairatu el-Mearif en-Nidhamijeh.

Përmbajtja

Parathënie	5
Kapitulli i parë	7
<i>Kuptimi i dëshmisë “Muhamed Resulullah”</i>	<i>7</i>
Kapitulli i dytë.....	12
<i>Paralajmërimet profetike.....</i>	<i>12</i>
<i>Paralajmërimi për Uvejs Karniun me përshkrim shumë të saktë ...</i>	<i>12</i>
<i>Paralajmërimi për vrasjen e Amar ibn Jasirit</i>	<i>13</i>
<i>Paralajmërimi për kohëzgjatjen e kalifatit të drejtë</i>	<i>14</i>
<i>Paralajmërimi se Fatimja do të jetë personi i parë nga familja që do të vdesë pas tij.....</i>	<i>14</i>
<i>Paralajmërimi për gruan e parë të tij që do të vdesë pas tij</i>	<i>15</i>
<i>Paralajmërimi se Haseni do t'i pajtojë dy grupe muslimanësh</i>	<i>15</i>
<i>Paralajmërimi se muslimanët do të bëjnë haxhillëkun edhe prej Shamit.....</i>	<i>16</i>
<i>Paralajmërimi për dëgjimin e zërit të qenve në vendin e quajtur Heveb</i>	<i>17</i>
<i>Paralajmërimi se Allahu do ta vrasë Musejleme Kedhabin (gënjeshtarin)</i>	<i>17</i>
<i>Profeti ﷺ i tregoi Enesit kush dhe me çfarë e kishte dërguar atë</i>	<i>18</i>
<i>Paralajmërimi për shkresën e Hatibit dërguar mekasve.....</i>	<i>19</i>
<i>Lajmërimi për vdekjen e Nexhashiut</i>	<i>20</i>
<i>Paralajmërimi për sigurinë që do të mbretërojë në Gadishullin Arabik</i>	<i>20</i>
<i>Paralajmërimi se nga fisi thekif do të dalë një gënjeshtar dhe një shkatërrues.....</i>	<i>21</i>
<i>Paralajmërimi për Omerin dhe Othmanin se do të bien dëshmorë (shehidë)</i>	<i>22</i>

<i>Paralajmërimi për përfundimin e titullit kisra dhe kajzer</i>	<i>23</i>
<i>Paralajmërimi se njëri nga shokët e tij do të vdesë i vetmuar në shkretëtirë, por atë do ta varrosin një grup muslimanësh</i>	<i>24</i>
<i>Paralajmërimi për daljen e disa njerëzve që do ta mohojnë Hadithin</i>	<i>25</i>
<i>Paralajmërimi për çlirimin e Egjiptit dhe për një ngatërresë që do të ndodhë në vendin Lebine.</i>	<i>26</i>
Kapitulli i tretë	28
<i>Lutjet profetike</i>	<i>28</i>
<i>Lutja që bëri për udhëzimin e nënës së Ebu Hurejrës</i>	<i>28</i>
<i>Lutja që bëri kundër parisë kurejshe</i>	<i>29</i>
<i>Lutja që bëri për Abdullah ibn Abasin.</i>	<i>30</i>
<i>Lutja që bëri për Enes ibn Malikun</i>	<i>30</i>
<i>Lutja kundër atij që nuk iu bind dhe hëngri me të majtën.</i>	<i>31</i>
<i>Lutja për kërkimin e shiut</i>	<i>32</i>
<i>Lutja kundër fisit mudarr</i>	<i>32</i>
<i>Lutja për udhëzimin e fisit deus</i>	<i>33</i>
<i>Lutja për udhëzimin e Omerit</i>	<i>34</i>
<i>Lutja për Seib ibn Jezidin</i>	<i>34</i>
<i>Lutja për Amër ibn Ahtab Ensariun</i>	<i>35</i>
<i>Lutja për largimin e epidemisë nga Medina</i>	<i>36</i>
<i>Lutja për Xheririn, që të bëhej i qëndrueshëm në kalërim.</i>	<i>37</i>
<i>Lutja për Urvën, që ta begatohej në tregti</i>	<i>37</i>
<i>Lutja kundër kalorësit që e ndiqte atë</i>	<i>38</i>
Kapitulli i katërt	39
<i>Veprat mrekulli</i>	<i>39</i>
<i>Shtimi i ujit në Hudejbije</i>	<i>39</i>
<i>Shtimi i ujit, i cili u mjaftoi treqind personave</i>	<i>39</i>

<i>Shtimi i ushqimit në ditën e Hendekut.</i>	<i>40</i>
<i>Të qarët e trungut për të</i>	<i>41</i>
<i>Guri e përshëndeste me selam.</i>	<i>42</i>
<i>Shërimi i syrit të Aliut</i>	<i>42</i>
<i>Kuptimi i gjuhës së devesë.</i>	<i>42</i>
<i>Shërimi i devesë së ngadalshme</i>	<i>43</i>
<i>Shërimi i Xhabirit me një spërkatje të ujit të abdesit</i>	<i>43</i>
<i>Largimi i dyshimeve të Ubej ibn Kabit</i>	<i>44</i>
<i>Sad ibn Ebu Vekasi e ndiente në vazhdimësi freskinë e dorës së tij</i>	<i>44</i>
<i>Ndodhia e Ebu Hurejrës, që të mos e harrojë hadithin profetik.</i>	<i>45</i>
<i>I sëmuri u ndëshkua pasi kundërshtoi optimizmin e tij</i>	<i>46</i>
<i>Shpëtimi nga atentati përmes deles së helmuar.</i>	<i>47</i>
Kapitulli i pestë	48
<i>A janë ndryshuar hadithet apo thëniet e tij?</i>	<i>48</i>
Kapitulli i gjashtë	52
<i>Dëshmi interesante rreth Profetit ﷺ</i>	<i>52</i>
Përfundim	57
Literatura	59

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

28 -32 (092)
929(532.2)Mohammed, Profet

Kabashi, Flamur
Profecitë : përshkrim i mrekullive të
profetit Muhamed / Flamur Kabashi. –
Mitrovicë : Vi-Print, 2018. – 66 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-523-41-7

Mitrovicë, 2018